

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7834 E enjte 28 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Skandali i përgjimeve të prokurorisë që tregonte se si dy shefa policie manipulonin me para në dorë dëshmitar-in kryesor të dosjes së Agron Xhafajt, i publikuar ...
Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI

Rilindja përballë pasqyrës së përgjimeve



Dje **në** "Deutsche Welle"

Është një nga ditët e para të pran-verës në Epanomi, një qytet bregdetar në afërsi të Selanikut. Në plazhin katër kilometra të gjatë të Potamos, ka ...
Vijon në faqen 21

Nga FLORIAN SCHULTZ

Sfida deti: Lufta e Greqisë për një nga burimet natyrore



Policia: Identifikuam autorin e atentatit

"Kur do t'i marrim lekët?", përgjimet që fundosën vrasësit e Jurgen Kurtit pas krimit

Shpallet në kërkim Klodian Bane, "Benz"-i me targa false çoi në zbulimin e ngjarjes

TIRANË - Një ditë pas arrestimit të tre të rinjve të dyshuar si bashkëpunëtorë në ekzekutimin e menaxherit të VIP-ve, Jurgen Kurti, burime nga policia bënë me dije se dyshohet që Klodian Bane është autori i vrasjes së 26-vjeçarit. Një javë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në rrugën "Zef Jubani" në kryeqytet, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me lëvizjet ...
Në faqen 9

NGJARJA NE GRUDE



Vrasja e "Nardit të Bujtinave", zbulohet emri i autorit që u arratis në Mal të Zi

Në faqen 8

INDEKSIMI I PENSIONEVE NIS NGA 1 PRILLI, SI NDAHET FONDI 2.3 MILIARDE LEKE

QEVERIA RRIT PENSIONET, PERFITOJNE 650 MIJE VETA

Shtesë 2.8% për të gjitha kategoritë. Vendimi i plotë: Pensionet e plota të invaliditetit bashkë me kompensimet, jo më pak se 13.700 lekë në muaj



(Në foto) Pensionistë (foto ilustruese)

Në faqen 7

KRYETARJA E LSI

Vuçiq mban zgjedhje të parakohshme, Kryemadhi: U tregua më i zgjuar se Rama

Në faqen 2

DEBATI NE KOMISION

Ndryshimet në diplomaci, kush janë të larguarit nga Gent Cakaj

Në faqen 3

DOKUMENTET

PD, kontrata lobimi në SHBA për ambasadorin e re në Shqipëri

Në faqen 5

DEBATI

Drejtori i Teatrit të Kukullave: Ka vlera historike, s'mund të shembet

Në faqen 19

"Procedura që duhet ndjekur për ata që nuk i kanë paguar kontributet e në të kaluarën"

Sigurimi i fermerëve, ISSH: 3 përfitimet që mund të kenë

Sa duhet të paguajnë të vetëpunësuarit në bujqësi, afatet

NGA VOLTIZA DURO

Përfshirja në skemën e sigurimeve shoqërore do të sjellë një sërë përfitimesh për fermerët që ushtrojnë aktivitetin e tyre bujqësor apo blegtoral. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se nga ky sigurim fermerët



mund të përfitojnë pension, kompensimin e çmimit të barnave në rast sëmundjesh si dhe vizita mjekësore falas. "Të nderuar fermerë! Sigurimi në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për ju që ushtrojnë aktivitetin bujqësor dhe blegtoral ...

Në faqen 10

ZGJEDHJET REFORMA

Bylykbashi: S'ka reformë pa opozitën, çdo hap i njëanshëm hedh në erë zgjedhjet

Valentina Madani

Partia Demokratike e quan antikushitetuse ndërhyrjen në Kodin Zgjedhor 3 muaj para zgjedhjeve, pasi bie ndesh me Kodin e Praktikave të Mira, sipas së cilit 6 muaj përpara zgjedhjeve nuk mund të bëhen amendime në ligjin elektoral. Për opozitën, një reformë që prek të gjitha partitë politike, siç është reforma zgjedhore, nuk mund të jetë veçse konsensuale. Në të kundërt, çdo hap i njëanshëm hedh në erë zgjedhjet. Ish-bashkëkryetari i Komisionit të Reformës Zgjedhore, Oerd Bylykbashi, shprehet se një ndërhyrje e tillë vetëm 3 muaj para zgjedhjeve do të ishte kaotike dhe se ajo bie ndesh me Kodin e Praktikave të Mira, që thotë se 6 muaj përpara zgjedhjeve nuk mund të bëhen amendime në ligjin elektoral. Oerd Bylykbashi ka më shumë se një dekadë që negocion reformën zgjedhore në emër të Partisë Demokratike dhe ai e vlerëson të rrezikshme çdo tentativë për të kaluar ndryshimet në Kodin Elektoral, në një moment që demokratët nuk janë në parlament. Paralajmërimi i Bylykbashit është i prerë, një lëvizje e njëanshme politike do ta çonte pas Shqipërinë në vitin 2000, kur PS-ja e ndryshoi e vetme Kodin dhe u deshën 10 vjet që dëmi të rregullohej. Pavarësisht se qeveria mund të rreshtojë 84 vota për të ndryshuar Kodin Zgjedhor, edhe faktori ndërkombëtar ka vënë në dukje se reforma elektorale duhet të kryhet në traditën e konsensusit të gjerë. "Thirrja e Edi Ramës është qesharake. Kodi Zgjedhor nuk ndryshon kur ka kaluar çdo afat, sepse do ta çonte procesin zgjedhor në kaos", u shpreh z.Bylykbashi për TV "Klan". Në mungesë të opozitës, që tashmë është jashtë parlamentit, kreu i qeverisë ka paralajmëruar se do ta kalojë Reformën Zgjedhore me opozitën e re, e cila zuri vendet e lëna bosh pas djegjes së mandateve nga deputetët e PD-së dhe LSI-së. Por, Bylykbashi shprehet se një gjë e tillë do të minonte politikisht procesin. Ai akuzoi se kryeministri Rama kërkon t'i bëjë këto ndryshime me disa deputetë që ka blerë. "Do të hidhte në erë çdo lloj besimi mbi procesin e zgjedhjeve dhe do të na kthente në vitin 2000, kur PS bëri e vetme ndryshimet në ligjin elektoral", theksoi ish-deputeti Oerd Bylykbashi. Ndërkombëtarëve, të cilët kanë apeluar për bashkëpunim mazhorancë-opozitë për reformën zgjedhore, Bylykbashi i kujton standardet, që sipas tij, çdu-

Ligji elektoral, PD: Kodi nuk ndryshohet 3 muaj para zgjedhjeve

"Ndryshimi me deputetë të blerë e fut procesin në kaos"



Ish-bashkëkryetari i Komisionit të Reformës Zgjedhore, Oerd Bylykbashi

ORED BYLYKBASHI
"Thirrja e Edi Ramës është qesharake. Kodi Zgjedhor nuk ndryshon kur ka kaluar çdo afat, sepse do ta çonte procesin zgjedhor në kaos", tha z.Bylykbashi. Në mungesë të opozitës, kryeministri ka paralajmëruar se do ta kalojë reformën zgjedhore me opozitën e re, e cila zuri vendet e lëna bosh pas djegjes së mandateve nga deputetët e PD-së dhe LSI-së.

FATMIR MEDIU
"Ne kemi diskutuar me zotin Basha që të marrim në analizë historinë elektorale dhe politike të së djathtës për të parë kush është sistemi më funksional, që i jep forcë qytetarit dhe shpejt do të kemi një diskutim analitik për të dalë në një qëndrim", u shpreh z.Mediu.

Opozita, sot protestë para parlamentit

Zgjedhje të parakohshme, Kryemadhi: Vuçiq u tregua më i zgjuar se Edi Rama



ekonomike, me atë varfëri që iu ka vajtur shumë thellë shqiptarëve. Në mbledhjen e sotme do diskutojmë edhe për anën organizative të strukturave të partisë. Jemi të bindur se Shqipëria do shkojë në zgjedhje të parakohshme. Protesta e nesërme (sotme) është një vazhdimësi e protestave jo të opozitës, por të shqiptarëve. Protestat që do vijjnë do jenë për ekonominë", tha Kryemadhi. Shpresat e Kryemadhit janë për një reflektim nga ana e PS-së. "Reagimi i ndërkombëtarëve gjithmonë fillimisht ka qenë stabiliteti, stabiliteti, stabiliteti. Por, më pas kur e kanë parë që

stabiliteti i shtetit të kapur ose stabiliteti i krimit të organizuar është kthyer në destabilitet për vendet e rajonit kanë reaguar menjëherë. Mendoj që çdo gjë është paketë. Serbia, Vuçiq u tregua si gjithmonë më i mençur dhe më i shpejtë se Edi Rama, i shpalli zgjedhjet e parakohshme për të mos e thelluar më tej krizën dhe për të mos e dëmtuar më tej partinë e tij. Besoj që edhe PS do të reagojë shumë shpejt, sepse çdo ditë që kalon e thellon më shumë krizën dhe vështirësinë ekonomike të shqiptarëve dhe rrit mospërkrahjen nga shqiptarët të qeverisë së kapur nga një grup kriminal", tha zj.Kryemadhi.

an në raportin e OSBE-ODIHR për zgjedhjet në Shqipëri. Opozita nuk ka ende një qëndrim zyrtar nëse do të hyjë apo jo në zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Ajo nuk i ka dërguar anëtarët për KZAZ në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe as propozimet për dy anëtarët që mungojnë në këtë komision. Opozita e ka fokusuar prej një muaji aksionin e saj në përpalljen me

protesta të mazhorancës, që e quan ilegjitime. E nëse kjo është njëra anë e medaljes, tjetra sipas aleatit të PD-së, Fatmir Mediu, është prezantimi i alternativës që përfshin edhe një sistem të ri zgjedhor. Alternativën ekonomiko-sociale Partia Demokratike e ka shpallur prej ndërtimit të saj me ndihmën e ekspertëve gjermanë të CDU-së së Merkelit. Por, alternativa e sistemit

politik, edhe pse në thelb të devizës së aksionit opozitar për ndryshim sistemi dhe jo qeverie, duket se mbetet ende për t'u identifikuar. "Ne kemi diskutuar me zotin Basha që të marrim në analizë historinë elektorale dhe politike të së djathtës për të parë cili është sistemi më funksional, që i jep forcë qytetarit dhe shpejt do të kemi një diskutim analitik për të dalë në një qëndrim",

u shpreh z.Mediu. Një pjesë e këtij qëndrimi, e artikulluar shpeshherë si nga aleatët e demokratëve, ashtu edhe nga kreu i këtyre të fundit, Basha, mbetet ajo e listave të deputetëve. "Duhet të krijojmë sistem parlamentar funksional, ku qytetarët vendosin kush i përfaqëson. Në situatën ku jemi këto janë sekondare, sepse kemi qeverinë kundër popullit të vet", deklaroi kreu i PR-së.



Gjatë një seance parlamentare



LSI: S'do të ketë negociata të Ramës me Metën

Nënkryetari i LSI-së, Petrit Vasili rrezoi dje çdo mundësi dialogimi me Ramën, madje përjashtoi si mundësi edhe tryejet në ndërmjetësimin e Presidentit Meta. Vasili deklaroi për "Top Channel" se të gjitha informacionet për dialog me Ramën, ku ndërmjetës do të jetë Presidenti Meta janë sajesa të zyrës së Ramës. "Këto janë lajme që prodhohen nga portalet e kapura nga Fuga, që hanë buken e pisët të Ramës. Ne nuk kemi thënë asnjë gjë të tillë. Ka vetëm një objektivi madhor, që është largimi i Edi Ramës si kryeministri i Shqipërisë, që ka krijuar trekëndëshin e tmerrshëm ku është futur Shqipëria: trafik droge-krim i organizuar-para të pista dhe që po rënon gjithmonë e më shumë Shqipërinë. Ky kryeministër jo vetëm i ka inkurajuar, por edhe i ka përdorur. Jo më larg se në një studio tjetër televizive u denoncuan zyrtarë të inkriminuar në audiopërgjime të reja me zyrtarë të lartë të policisë që i mban Edi Rama. Nuk mund të jetë ky që të negociojë në emër të askujt. Detyra jonë është zgjedhje të lira dhe të çlirojmë shtetin nga kapja", theksoi z.Vasili.



Largimi dhe lëvizja e 20 diplomatëve që shërbejnë jashtë shtetit nga Ministria e Jashtme është bërë objekt debatësh dhe në Komisionin e Integritimit, ku zëvendësministri i Jashtëm, Gent Cakaj, ishte ftuar të raportonte mbi procesin e integritimit. Ka qenë deputetja demokrate, Rudina Hajdari, ajo që i ka kërkuar llogari prej tij lidhur me 'furtunën' ministrinë që ai drejton, ndërsa ka theksuar se ky veprim bie ndesh me atë që kishte deklaruar më parë ish-ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati. "Keni vendosur të shkarkoni rreth 20 punonjës. Ju thoni se për shkak se këta punonjës nuk përmbushin fushën ligjore dhe keni vendosur t'i shkarkoni. Nëse ju do luftoni klientelizmin, mund të na thoni pse nuk keni dhënë një arsye për 20 punonjësit", - tha Hajdari. Por, zëvendësministri duke iu përgjigjur këtij shqetësimi sqaroi se nuk janë të gjitha largime, pasi mes tyre ka edhe lëvizje në

Furtuna në diplomaci, Gent Cakaj: Do të ketë valë të tjera ndryshimesh



Zëvendësministri i Jashtëm, Gent Cakaj

detyrë. "E para, citimi i deklaratës sime nuk ishte saktë për faktin që kam vendosur të shkarkoj 20 punonjës. Unë kam thënë se me një pjesë të punonjësve është bërë shkëputja e marrëdhënies së punës dhe për një pjesë do të bëhet transferimi. Por, nuk janë bërë 20 shkarkime nga puna. Në diplomacinë tonë në botë ka një disbalancë ndërmjet numrit dhe rezultatit. Një pjesë e tyre nuk mund të qëndrojnë 7 vite në

sisteme diplomatike pa asnjë transferim. Mos ki frikë, për çdo emër që është larguar nga puna dhe është bërë transferata, do të bëhet publike. Unë pres valë të tjera ndryshimesh, nëse performanca nuk është në nivelin e duhur", - tha Cakaj. Ndërkohë, kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, e ka mbështetur Cakajn në vendimin për shkarkimin e 20 diplomatëve në shërbimin diplomatik, ndër-

sa tha se priste një numër edhe më të madh. "Ju lutem, mos u kompleksoni nga kritikant dhe sulmet që vijnë nga opozita. Mua më duken pak 20", - deklaroi Balla. Ndërkohë që në media dhe qarkulluan edhe disa emra diplomatësh, që janë bërë pjesë e listës së shkarkimeve në diplomaci. Ndërkohë që janë zbardhur edhe disa lëvizje në shërbimin diplomatik. Florian Nova dhe Enkelejdja Riza nga ambasada jonë në Greqi sipas 'News 24' do të jenë në shërbim të Ministrisë së Jashtme. Më herët u bë i ditur largimi i Pranvera Skanës, këshilltari pranë ambasadës shqiptare në Londër. Gjithashtu konsulli shqiptar në Romë, Edmond Kumaraku u shkarkua nga ministria e Jashtme ashtu si edhe konsulli shqiptar në Athinë.

Arben Elezi, Adriatik Alimadhi dhe Ambra Borova janë 3 deputetët e rinj

KQZ jep 3 mandate të tjera, Kuvendi plotëson grupet e PD dhe LSI

Nis zëvendësimi i komisionerëve të opozitës

Shkon në 99 numri i deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u dha dhe mandatin e deputetit 3 kandidatëve të tjerë, që vijnë nga listat shumëpartiake të Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, duke e çuar kështu në 99 numrin e përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë. Më konkretisht, KQZ-ja i dha mandatin kandidatit nga radhët e Partisë Demokratike për qarkun e Elbasanit, Arben Elezi, i cili zëvendëson Edmond Spahon. Ndërkohë edhe në Vlorë, kreu i Ballit Kombëtar, Adriatik Alimadhi ka marrë mandatin ish-deputetit të PD-së, Agron Shehaj. Kujtojmë se Partia Balli Kombëtar që drejton Alimadhi është aleate me Partinë Demokratike, pavarësisht se Alimadhi ka kandiduar si pjesë e listave të PD-së për qarkun Vlorë. Në qytetin e Shkodrës, KQZ-ja i ka kaluar mandatin Ambra Borovës, e cila i ka marrë mandatin ish-deputetit nga radhët e LSI-së, Agron Çelaj. Së bashku me 3 deputetë që kanë marrë mandatin dhe, opozita ka në parlament 20 deputetë, ndërkohë që mazhoranca 79.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

GRUPET
Grupi PD-së është bërë aktualisht me 5 anëtarë, ku veç Myslim Murrizit dhe Rudina Hajdarit, janë bërë pjesë edhe Lefter Maliqi, Ligoraq Karamelo dhe Majlinda Halilaj. Ndërkohë që grupi i LSI-së ka arritur në 8 anëtarë. Përveç Lefter Kokës, që ishte pjesë e këtij grupi, administrata e Kuvendit ka bërë pjesë të saj edhe deputetët Ylli Shehu, Enver Roshi, Edmond Rrushi, Aurora Mara, Ediola Braha, Edlira Hyseni dhe Elda Hoti.

bërë betimin t'i shpërndajë nëpër komisionet parlamentare, respektivisht të forcave nga të cilat vijnë. Kështu, grupi parlamentar i Partisë Demokratike është bërë aktualisht me 5 anëtarë, ku veç Myslim Murrizit dhe Rudina Hajdarit, janë bërë pjesë edhe Lefter Maliqi, Ligoraq Kara-

Edlira Hyseni dhe Elda Hoti. Gjithsesi, kemi të bëjmë me një vendim jorregull nga ana politike, pasi PD dhe LSI i ka kërkuar zyrtarisht KQZ-së që të mos i njohë kandidatët që kanë marrë mandatin si përfaqësues të tyre.

KOMISIONERËT
Ndërkohë që në kushtet kur opozita e bashkuar ka hequr dorë nga mandatet e deputetit dhe përgatitja e procesit të ardhshëm zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes kreut të saj, Klement Zguri, iu është drejtuar me një thirrje qytetarëve shqiptarë. Ai ftoi të gjithë qytetarët që të aplikojnë për komisionerë të KQZ-ve, duke sfiduar kështu hapur vendimin e opozitës për mosdorëzimin e listave për komisionerë, pavarësisht thirrjeve të përsëritura. "Thirrje për qytetarët të aplikojnë për komisionerë, pasi KQZ-ja bën emërimet kryesisht sipas ligjit. Kjo, për shkak se partitë nuk kanë deponuar anëtarët për komisionerë", - tha ai gjatë mbledhjes së KQZ-së. Kujtojmë se Kodi Zgjedhor parashikon që në rastin kur njëra nga forcat që ka të drejtën të propozojë komisionerë nuk e ushtron atë, atëherë ai mund të emërohet komisionerë kryesisht. Ata janë qytetarë që punësohen dhe trajnohen nga KQZ-ja për të qenë komisionerë.

Nuk bind për Bashkinë e Vlorës, PS rikthen në sondazh Dritan Lelin

Ndërsa zgjedhjet e 30 qershorit janë në prag, mazhoranca ka konfirmuar vetëm disa kandidatë nga 61 në total për kryetarë të bashkive. Lidhur me përzgjedhjen e tyre, PS ka ngritur një shtab special pranë selisë, përmes sondazheve të të cilit pritet të bëhet vlerësimi për kandidatët që do të garojnë në zgjedhjet vendore të qershorit. Kongresi i 23 marsit i PS-së konfirmoi 7 prej tyre për bashkitë kryesore në vend, ndërmjet të cilëve ishte edhe kryebashkiaku aktual i Vlorës, Dritan Leli. Por edhe pse iu drejtua me një fjalim kongresit, ç'ka la të mendohej se edhe Dritan Leli konfirmohej për një mandat të dytë për Bashkinë e Vlorës, burime nga PS thanë për "BalkanWeb" se skuadra, e cila merret me sondazhet e kandidatëve ka kërkuar edhe një herë opinionin e publikut, duke e kaluar në sondazh edhe kryebashkiakun e Vlorës, Dritan Leli. Për të shmangur çdo pakënaqësi në qarkun ku vetë kryeministri është deputet dhe për të qenë të sigurt se Leli është kandidatura e duhur në 30 qershor, skuadra e sondazheve në PS ka nisur të zhvillojë edhe një herë të marrë mendimin e qytetarëve. Duket se rezultati i sondazhit do të përcaktojë edhe faktin nëse Leli do të konfirmohet për një mandat të dytë apo jo.



Vendimi, PDK e Nard Ndokës dhe PR e Fatmir Mediut, me seli të re

Qeveria në mbledhjen e saj ka vendosur që t'u ofrojë seli të re dy kundërshtarëve të saj politik. Në një nga vendimet më të fundit, Rama ka vendosur që t'i japë seli Partisë Republikane dhe Partisë Demokratiane. Këto dy parti janë aleatë të PD-së, ku drejtohet e saj, Fatmir Mediu dhe Nard Ndoka si pjesë e koalicionit opozitar po kërkohet largimin e qeverisë dhe krijimin e zgjedhjeve të parakohshme. Vendimi i qeverisë i cakton selitë e dy partive në ish-shtëpinë botuese "8 Nëntori". Që të dyja partitë do të kenë selinë e tyre në të njëjtën godinë. Më parë, selitë e PR dhe PDK kanë qenë në zonën pas hotel "Plaza", në godinën ku ndodhet edhe AMA.

SKANDALI PËRGJIMET

Përgjime të reja për dosjen "Xhafaj": Shefi i madh bleu dëshmitarin e rremë

"Babalja", Saliانji: Alizoti, dëshmitar i blerë nga qeveria

PD padit drejtuesit e policisë në Fier dhe prokurorët

Valentina Madani

Partia Demokratike publikoi dje dy audio-përgjime të reja, që sipas saj faktojnë se drejtues të lartë të policisë së Fierit kanë paguar dëshmitarin e rremë të dosjes "Babalja", Fredi Alizoti, për llogari të ish-ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, i cili sipas selisë blu, provohet në përgjim se është shefi i madh. Ish-deputeti Ervin Saliانji deklaroi dje se përgjimi është i datës 7 qershor i vitit 2018 dhe në kohën kur biseda është bërë mes Alizotit dhe ish-drejtorit të policisë së Fierit, ish-ministri Xhafaj rezultoi të ketë qenë në një vizitë pune në Kroaci. Dy përgjimet sipas opozitës faktojnë vendosjen e policisë, prokurorisë dhe qeverisë nën urdhrat e vëllait trafikant të ish-ministrit të Brendshëm dhe për këtë arsye, Partia Demokratike ka vendosur të kallëzojë penalisht drejtuesit e policisë së Fierit dhe 4 prokurorët e çështjes "Xhafaj" për shpërdorim detyre, falsifikim të provave dhe fshehjen e së vërtetës. Saliانji ka vendosur të kallëzojë penalisht drejtuesit e policisë së Fierit dhe prokurorët e çështjes. Pasi publikoi dy përgjime të reja ku përmendet "shefi i madh", Saliانji thekson se ai është ish-ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj. "Sot (dje) po bëjmë publike dy përgjime, që faktojnë jo vetëm se drejtuesit e policisë në Fier paguan dëshmitarin e sajuar Fredi Alizoti, por që ai që ka deleguar qepjen e kësaj afere është edhe ai që në bisedë quhet 'shefi i madh' dhe që faktet provojnë se ai është Fatmir Xhafaj. Edi Rama vuri bast karrigen e kryeministrit, kur opinioni publik u njoh me faktet tronditëse të trafikut të drogës nga vëllai i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Në atë kohë, Edi Rama shpalli i pari pafajësinë e Agron Xhafajt dhe akuzoi Partinë Demokratike se kishim sajuar ngjar-



Ish-deputeti i PD-së, Ervin Saliانji

AKUZAT

"Dy përgjimet faktojnë jo vetëm se drejtuesit e policisë në Fier paguan dëshmitarin e sajuar Fredi Alizoti, por që ai që ka deleguar qepjen e kësaj afere është edhe ai, që në bisedë quhet 'shefi i madh' dhe që faktet provojnë se ai është Fatmir Xhafaj", deklaroi ish-deputeti i PD-së.

"Fakte tronditëse, audiopërgjime"

LSI, Vasili: Policia tërhiqet për gryke nga kriminelët

Ish-deputeti i LSI, Petrit Vasili, u bëri dje thirrje qytetarëve që t'i bashkohen opozitës për të larguar qeverinë. Një ditë para protestës së thërritur nga opozita para Kuvendit të Shqipërisë, Vasili u bën apel shqiptarëve të mos frikësohen, por të jenë të gjithë bashkë kundër qeverisë, që nuk i përfaqëson më ata, por kriminelin. Në një deklaratë për mediat nga selia e LSI, Vasili duke u ndalur te përgjimet e fundit të publikuara nga PD-ja për çështjen "Babalja", deklaroi se këto fakte tregojnë qartë se policia është nën presionin e kriminit dhe se është ky i fundit që drejton.



Sipas Vasilit, e vetmja mënyrë për t'u larguar nga krimi është nëpërmjet largimit të qeverisë. "Asnjë qytetar nuk trembet nga kjo

qeveri dhe pikërisht janë dhe do të jenë në sheshe sepse do të çlirohen një herë e përgjithmonë prej tyre. Edhe një herë faktet tronditëse të cilat janë në duart e qytetarëve, audiot e përgjimeve, ku policia tërhiqet për veshi, për gryke nga kriminelët, të cilët e keqtrajtojnë, i dhunojnë dhe njëkohësisht paguhen prej saj, janë fakte të cilat do të mbeten të pashlyera në memorien e shqiptarëve. Ato do të marrin shpëtimin vetëm me protestën e madhe mbarëpopullore, e cila çliron njëherë e përgjithmonë Shqipërinë dhe vendos një standard të ri shumë të qeverisjes", tha z.Vasili.

Opinionin publik e ka parë përgjatë gjithë këtij viti sesi policia dhe prokuroria u vunë në shërbim të karrigës së Edi Ramës dhe u investuan me sajimin e dëshmitarit të rremë kundër opozitës. Ata sajuan dosjen sipas porosisë së Edi Ramës dhe Fatmir Xhafajt për të marrë të pandehur denoncuesit e kriminit qeveritar", deklaroi z.Saliانji. Por sipas tij, të verbuar nga pushteti, lanë pas në dosje gjurmët

tronditëse të vënies së shtetit në shërbim të mbulimit të kriminit dhe falsifikimit të provave. "Dosja 'Xhafaj' është prova më konkrete se Shqipëria është sot një narkodemokraci, ku policia dhe prokuroria nuk janë në shërbim të zbulimit të së vërtetës, por të linçimit të kundërshtarëve të qeverisë dhe mbrojtjes së trafikantëve të drogës, në këtë rast të vëllait të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafajt. Përgjimet zyr-

tare që prokuroria në mënyrë të paligjshme nuk i ka zbardhur faktet në dëshmitari i Edi Ramës është i sajuar, është blerë dhe mbajtur me lekë për llogari të pushtetit të Edi Ramës", theksoi Ervin Saliانji. Sipas tij, përgjimet zyrtare faktojnë në mënyrë tronditëse vendosjen e policisë, prokurorisë, dhe qeverisë nën urdhrat e një trafikanti të dënuar, që mori përsipër rolin e shpëtimtarit të qeverisë së Edi Ramës".



Diplomatja amerikane, Kathleen Ann Kavalec

SALI BERISHA

Ish-kryeministri Berisha publikoi dje mesazhin e një studenti ekselent, që pretendon se në spitalin e Krujës, emërimet në detyrë nuk janë bërë sipas listës së studentëve ekselentë, por me mik. Denoncuesi shprehet se vendin e një studenti me mesatare 9,4 e zuri një person i punësuar me mik, ndërsa këtij të fundit ia kishin hequr fare emrin nga lista.



Protesta, banorët e 'Unazës': Nuk ndalemi, projekt korruptiv

Banorët e 'Unazës së Re' dolën sërisht dje në protestë kundër projektit që rrezikon shembjen shtetërore të tyre. Në ditën e 144 të protestës banorët kanë bllokuar rrugën. Ata për dy net me radhë e gdhinë para Drejtorisë së Policisë, ku edhe kërkuan lirinim e 7 të shoqëruarve. "Do të mblihem të gjithë aty dhe të protestojmë para parlamentit. Banorët të 'Unazës së Re' janë më të përgatitur se kurrë për të kundërshtuar. Është zbuluar se është një projekt korruptiv, ndaj ne nuk na largoni dot nga rruga as me polici, as me ushtri. Edhe po përfunduan në burg 5-6 veta, ne këtu jemi me qindra për të mbrojtur pronën tonë. Falënderoj opozitën shqiptare që e ka mbështetur këtë protestë. Mbështetja është e madhe për kauzën tonë, nuk kemi frikë nga askush. Kryetari i Bashkisë ta harrojë se mund të kundërshtojë banorët e 'Unazës së Re'. E di që jemi të lodhur, por është e vetmja mënyrë për të mbrojtur këto prona", - u shpreh një nga banorët. Të pranishëm në protestë, në mbështetje të banorëve ishin edhe ish-deputetë të opozitës si nga LSI-ja, ashtu edhe nga PS. Nga protesta, Balliu ftoi të gjithë qytetarët t'i bashkohen protestës së opozitës së planifikuar për sot. "Ndaj nesër (sot) të gjithë bashkë në 9 e gjysmë të jemi përballë Kuvendit, t'i tregojmë se kush komandon dhe se kush është sovranin", - u shpreh Balliu.

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shqiptarë, faza e DYTE, për shifren e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vlerë hyrëse: NISB BANKAËSI BANK, me kate të dhëna: Nr. 1287-N1, ZK. 856z, VOL. 30, FAG. 91 e llogji njësi me sip. 109 m2 ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babani", Korçë në pronësi të Pandelli Borja. Çmimi me të cilin fillon ankandë është në vlerën 48.832 EUR (dyzetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) EUR Nr. 1287-N2, ZK. 856z, VOL. 30, FAG. 93 e llogji njësi me sip. 89,2 m2 ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babani", Korçë në pronësi të Pandelli Borja. Çmimi me të cilin fillon ankandë është në vlerën 39.961 EUR (tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një) EUR Ankandë zbulohet në datën 29.04.19, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbartësuesit qëlluesor me Adresë: Bulevardi Bajram Curri, Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890



Partia Demokratike përfshihet në një tjetër çështje që ka si objekt lobimin pranë institucioneve të larta vendimmarrëse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndërsa prokuroria në Tiranë ka nisur hetimet mbi hijet e dyshimit të një skandali të pretenduar dhe të publikuar për herë të parë nga "Mother Johns", mediat në Tiranë kanë publikuar dje të dhëna për përfshirjen e selinë blu në një tjetër lobim. Kësaj here qëllimi ka qenë që të ndikojë të senatorët amerikanë dhe anëtarët e Komisionit të Jashtëm në Senatit Amerikan lidhur me të nominuarën e Presidentit Trump për ambasadore në Shqipëri, Kathleen Ann Kavalec, si dhe për forcimin e zërit të Washingtonit zyrtar ndaj kriminalitetit, narko-trafikut dhe terrorizmit. Këtë herë ajo i ka besuar paratë e saj "Sonoran Policy Group", kompania e re lobuese e PD-së në Uashington, e cila gjatë periudhës 8.05.2018 deri më 7.9.2018 ka llobar fort te anëtarët e Senatit Amerikan për procesin e përzgjedhjes nga ata të Kathleen Ann Kavalec si ambasadore në Shqipëri dhe për disa çështje të sigurisë. Në muajin gusht 2018, e nominuara për ambasadore të re në Shqipëri Kathleen Kavalec, pritej të dilte përpara senatit në secënç dëgjimore përpara nominimit. Edhe pse ishte parashikuar në datë 16 gusht, seanca nuk u zhvillua asnjëherë. Në të njëjtën periudhë, siç raporton vet firma lobuese Sonoran Policy Group, kjo e fundit ka nisur një fushatë email-esh dhe telefonatash për llogari të Partisë Demokratike, ku subjekti i bisedave është korrupsioni në Shqipëri, siguria, narko-terrorizmi, por dhe nominimi i Ambasadores Kavalec. Rezultoni që nga data 5 gusht deri në 10 tetor, lobuese Christian Bourge ka kryer 11 vprime për llogari të Partisë Demokratike, me subjekt edhe nominimin e ambasadores Kavalec, shërbime për të cilat raportoni se është paguar 40 mijë dollarë. Per-

Zbulohen dokumentet e kompanisë që lloboi në emër të PD-së në Senatit Amerikan

PD në tjetër lobim në SHBA, kësaj here për ambasadoren Kavalec

Kompania mësohet se është paguar 40 mijë \$



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

sonat e kontaktuar janë, senatorët Ron Johnson, John Barraso dhe Rob Portman, të tre Republikan dhe të tre pjesëtarë të Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë, përpara të cilit Kavalec do të fliste. Partia Demokratike e pyetur nga mediat në Tiranë lidhur me qëllimin dhe synimin e këtij lobimi zyrtarisht deklaroi se: Lobimi i Partisë Demokratike ka patur si qëllim çështjet e narko-trafikut, kriminit të organizuar dhe kapjes së shtetit, probleme të cilat ishin ngritur me nota shumë serioze në raportin e Departamentit të Shtetit për Strategjinë e Kontrollit të "Narkotrafikut Ndërkombëtar për vitet 2017 dhe 2018. Në këto raporte Shqipëria cilësohet "bazë operacionale e kriminit të organizuar rajonal", "pikë kyçe e shpërndarjes së heroïnës në gjithë Europën" dhe "vend kryesor i pastrimit të parave në botë". Me senatorët e Komisionit të Jashtëm është diskutuar për ngritjen e këtyre problemeve në secënç dëgjimore me ambasadoren e emëruar dhe nxitjen e saj për të bërë prioritet të punës së saj në Tiranë luftën kundër narkotrafikut, kriminit të organizuar dhe korrupsionit". Ndërkohë që të gjithë zyrtarët, emrat e të cilëve janë të përmendura në dokumentet e "Sonoran Policy Group", nuk preferuan të komentonin asgjë në lidhje me çështjet të cilat janë diskutuar.

AMBASADORJA

Emri Kathleen Ann Kavalec, e nominuara e Presidentit Trump për ambasadore në Shqipëri, u rikthye në vëmendjen e medias shqiptare disa ditë më parë, pasi Sarah Carter, gazetare e "Fox News", tha se zyrtarja e DASH-it ka komunikuar me ish-agjentin britanik, Christopher Steele, i cili kishte hartuar një dosje me pretendime shkeljesh e komploti ndërmjet fushatës presidenciale të Trumpit dhe Moskës në zgjedhjet e vitit 2016. Sipas saj, kjo ishte arsyeja përse Senati nuk e shqyrtoi kandidaturën e saj.

Ristani: Debatimi për lobimet, për të fshehur zullumet e qeverisë

Ish-sekretari i Përgjithshëm demokrat, Arben Ristani deklaroi dje se e gjithë zhurma e ngritur për lobimin rus në favor të PD bëhet për të fshehur zullumet e qeverisë. Ai argumentoi se Lulzim Basha dhe zyrtarë të tjerë të PD-së, nuk janë thirrur në prokurori për çështje të tilla të përfolura që kanë të bëjnë me lobimin rus, por janë thirrur lidhur me deklaratimet që PD ka bërë në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve. "Për të fshehur zullumet e qeverisë përpiqet të ndërtojë akuzat kundër kundërshtarit politik. Ne jemi thirrur



por që nuk kanë të bëjnë me thirrjen që ka bërë Prokuroria e Përgjithshme. Partia Demokratike është një parti, e cila ka sjellë demokracinë në këtë vend, është përpjekur me të gjitha forcat e veta për të ndërtuar një shtet modern dhe ka zbatuar gjithmonë procedurat ligjore. Asgjë tjetër përveç atyre që kemi deklaruar nuk ka", - tha Ristani. Ai shpjegoi edhe burimet e të ardhurave të Partisë Demokratike duke thënë se tre janë kryesorët: të ardhurat nga shteti, donacionet dhe kuotat e anëtarësisë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6,800,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 23 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qendrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,400,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qendrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 18 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Ikën drejtoresha e Tatimeve dhe ajo e Doganave. Financat publike, rokadë "shefash"

Këshilli i Ministrave ka emëruar Belinda Ikonomin si zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, duke zëvendësuar Albana Shkurtën dhe duke e liruar nga detyra e mëparshme si drejtoresha e përgjithshme e Doganave. Drejtori i përgjithshëm i Doganave sipas vendimit, i cili ka hyrë në fuqi menjëherë është emëruar Arlind Gjokuta. Në krye të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do të jetë Enton Duro, duke zëvendësuar Vasilika Vjeron.

TATIMET E DOGANAT

Belinda Ikonomin lirohet nga detyra, Arlind Gjokuta emërohet drejtor i përgjithshëm i Doganave. Vasilika Vjero ikën nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vjen Enton Duro.

more në muajin shkurt të këtij viti ishin 1.7 për qind më të ulëta se një vit më parë. Ndërkohë që edhe të ardhurat doganore janë në vesh-tirësi, për shkak të impo-rtave më të ulëta në mallrat e ak-

cizës. Doganat grumbulluan 725 milionë lekë ose rreth 6 milionë euro më pak se dy muajori i vitit 2018, ku rënia më e madhe u vu në arkëtimet nga TVSH-ja, me rreth 427 milionë lekë më pak. Rënia u shënuar edhe nga arkëtimet e akcizës dhe taksës doganore etj. Ndryshime të tjera janë bërë edhe në qarkun e Shkodrës, ku Këshilli i Ministrave ka vendosur lirimim nga detyra të Çesk Milljas,



prefekt i këtij qarku duke emëruar si prefekt të ri Valdrin Pjetri. Anëtar i Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit të Ujërave të Ndotura, Rudolf Papa, është larguar po ashtu nga detyra për shkak të dorëheqjes.

Kompanive të sigurimit u bie ritmi, paguajnë më pak se në 2018-ën

Dëmet nga aksidentet, kompanitë rrisin arkëtimet e ulin pagesat

Numri i kontratave të sigurimit shënoi rritje me 5.59%

Në dy muajt e parë të këtij viti kompanitë e sigurimit kanë paguar në total më pak dëme se e njëjta periudhë e një viti më parë. Sipas të dhënave zyrtare nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pagesat e dëmeve gjatë periudhës janar-shkurt 2019 u ulën me 6.78% krahasuar me periudhën janar-shkurt 2018. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.83 milionë lekë, apo 63.30% të totalit të dëmeve të paguara bruto. Në të kundërt kanë ecur ndërkohë treguesit që lidhen me ecurinë e primeve të shkruara bruto në përgjithësi për tregun e sigurimeve.

RAPORTI

Sipas AMF-së, të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-shkurt kapën vlerën mbi 2,3 miliardë lekë, ose 1.37% më shumë se në periudhën janar-shkurt 2018. "Gjatë periudhës janar-shkurt 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 177,450, me një rritje prej 5.59% krahasuar me periudhën janar-shkurt 2018. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar të sigurimit e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.08% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.76% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.16%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 35.82% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 64.18% të totalit të tregut", vlerëson AMF.

SIGURIMI I DETYRUESHËM

Të dhënat tregojnë se primet e sigurimit të detyrueshëm motorik gjatë periudhës janar-shkurt 2019




Foto ilustruese

TË ARDHURAT

"Gjatë periudhës janar-shkurt 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 177,450, me një rritje prej 5.59% krahasuar me periudhën janar-shkurt 2018. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar të sigurimit e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.08% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.76% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.16%.

arritën rreth 1.52 milionë lekë, ose 5.56% më shumë se në periudhën janar-shkurt 2018. "Produkti MTPL e brendshme, në periudhën janar-shkurt pati një rritje prej 5.12% të vëllimit të primeve të shkruara bruto. Kjo u shoqërua edhe me një rritje të numrit të kontratave prej 5.46% krahasuar me periudhën janar-shkurt

2018. Produkti Karton Jeshil në periudhën janar-shkurt pati një rritje prej 11.39% të vëllimit të primeve të shkruara bruto. Kjo u shoqërua nga një rritje e numrit të kontratave prej 52.03% krahasuar me periudhën janar-shkurt 2018. Produkti Sigurim Kufitar, në periudhën janar-shkurt pati një ulje 18.10% të vëllimit të primeve

të shkruara bruto krahasuar me periudhën janar-shkurt 2018. Ndërsa numri i kontratave u ul me 17.04%", - thuhet në raportimin e AMF. "Primet e sigurimit vullnetar gjatë periudhës janar-shkurt 2019 arritën rreth 0.85 milionë lekë, 5.35% më pak se në periudhën janar-shkurt 2018. Numri i kontratave të sigurimit vullnetar u ul me 1.33% krahasuar me periudhën janar-shkurt 2018. Sigurimet vullnetare të Jo-Jetës gjatë periudhës janar-shkurt 2019 patën ulje me 6.76% kundrejt periudhës janar-shkurt 2018. Në portofolet e pronës, përgjegjësi, garancive të cilat gjatë periudhës janar-shkurt 2019 siguruan mbi 0.35 milionë lekë të ardhura në total, vendin e parë e zunë zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë me rreth 74.72%, të pasuara nga sigurimi i garancisë me 13.30% të totalit. Në portofolin sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës, gjatë periudhës janar-shkurt 2019 vihet re një ulje prej 2.41% e vëllimit të primeve të shkruara bruto të këtij portofoli dhe një rritje me 5.27% e numrit të kontratave të sigurimit, krahasuar me periudhën janar-shkurt 2018. Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit gjatë periudhës janar-shkurt 2019 arritën në rreth 0.18 milionë lekë, duke shënuar ulje prej 18.38% në krahasim me periudhën janar-shkurt 2018. Primet nga sigurimet e Jetës gjatë periudhës janar-shkurt 2019 arritën rreth 0.16 milionë lekë, ose 1.43% më shumë se në periudhën janar-shkurt 2018", thuhet në raportin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

DPT: Mbi 25 mijë tatimpagues të informuar mbi ndryshimet, ulet barra fiskale

Drejtorja Përgjithshme e Tatimeve ka njoftuar se vitet De fundit ndryshimet tatimore kanë ulur barrën fiskale për tatimpagues dhe janë orientuar nga objektivat e qeverisë për të stimuluar sektorët prioritarë të ekonomisë, apo kategori të caktuara biznesi. Gjatë një takimi të zhvilluar me bizneset në kryeqytet, diskutuar mbi planin kombëtar të komunikimit për informimin e publikut dhe prezantimin e ndryshimeve të legjislacionit tatimor, në kuadër të Paketës Fiskale 2019, zv. ministri i Financave dhe Ekonomisë, Elton Haxhi dha një mesazh për të gjithë të pranishmit. Haxhi theksoi faktin se deri më tani në rang kombëtar janë informuar më shumë se 25 mijë tatimpagues, nëpërmjet disa kanaleve të ndryshme të komunikimit dhe se synimi kryesor është që tatimpaguesit të jenë në dijeni të kuadrit ligjor dhe të mos ketë mospërbushje të detyrimeve tatimore për shkak të mosinformimit. Sipas njoftimit të zëvendësuesit të përgjithshëm i 'Tatimeve', Khavit Curri po punohet për uljen e shumës së rimbursimit të TVSH-së dhe në muajt e ardhshëm kjo do të jetë një ndër prioritetet e administratës tatimore. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në fund të vitit të kaluar hartoi dhe miratoi një plan kombëtar komunikimi, me qëllim informimin e publikut dhe prezantimin e ndryshimeve të legjislacionit tatimor, me hyrjen në fuqi të Paketës Fiskale 2019. Me anë të këtij plani u synua informimi i tatimpaguesve të çdo fashe qarkullimi, për ndryshimet e legjislacionit tatimor, të cilat hynë në fuqi në datë 1 janar 2019. Sipas njoftimit të DPT, si rezultat i zbatimit të këtij plani komunikimi u arrit që për periudhën 15 janar-28 shkurt të informohen gjatë takimeve në 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore 877 konsulentë fiskalë, ekonomistë dhe ekspertë kontabël, të cilët përfaqësojnë 12,843 tatimpagues në rang vendi. Për periudhën 1 shkurt-15 mars të informohen në terren nga punonjësit e Shërbimit të Tatimpaguesve në 14 DRT në total 15,508 tatimpagues me një shkallë realizimi 122% krahasuar me targetin e caktuar. DRT Tirana shënoi numrin më të madh të tatimpaguesve të informuar në terren me 2,520 dhe me një shkallë realizimi në 114%, e ndjekur nga DRT Durrës me 1,500 tatimpagues të informuar ose me një shkallë realizimi në masën 174%; DRT Shkodër me 1,350 tatimpagues të informuar me një shkallë realizimi 125% dhe duke vijuar me DRT Fier, DRT Vlorë DRT Gjirokastrë, secila me nga 1,080 tatimpagues të informuar.

Qeveria miraton indeksimin e pensioneve në masën 2.8% për të gjitha kategoritë

Rriten pensionet, si ndahet fondi 2.3 mld lekë për 650 mijë përfitues

Efektet financiare nisin nga 1 prilli i këtij viti

Këshilli i Ministrave vendosi dje rriten e pensioneve në masën 2.8%. Në dispozicion të rreth 650 mijë pensionistëve është vënë një fond prej 2.3 miliardë lekësh. Shtesa e pensionit do të nisë në 1 prill. Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore përveç rritjes me 2.8%, do të përfitojnë edhe kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit, me kusht që shumica e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave të jetë: a) deri në 15 403 lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, b) deri në 14 903 lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare; c) deri në 10 108 lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare. Kompensimet për të ardhura mujore minimale nisin nga 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që shumica e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 403 lekë në muaj. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përlogariten në shumën 2.4 miliardë lekë dhe përballohen nga fondit për politikë dhe indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e ISSH-së të vitit 2019, të cilat ndahen: a) 2.3 miliardë lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve; b) 14 milionë lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensione nga Posta Shqiptare, sh.a.

VENDIMI

Qeveria vendosi indeksimin në masën 2.8 për qind për 16 kategori pensionesh dhe përcaktoi kufirin minimal dhe maksimal për pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.4.2019 e në vazhdim dhe përfituesit e pensioneve, sipas ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993. Sipas vendimit, mësohet se përfitojnë rritje pensionet e caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", pensionet sociale. Shtesa mujore në masën 2.8% do të përfitojnë edhe personat që trajtohen me mbrojtje të veçantë të ushtarakut, pensionet suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimin dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë". Rritje në masën 2.8% do të përfitojnë edhe rastet e trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të



Foto ilustruese

PERFITUESIT

Pensionet që përfitojnë nga vendimi janë pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr.150/2014.

pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar dhe nr.9128, datë 29.7.2003, "Për një trajtim të veçantë

financiar të pilotëve fluturues, në pension", të ndryshuar dhe rastet e trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruar të nën-

detëve dhe palombarëve të forcave detare në pension". Rritja do të aplikohet për personat që trajtohen me pagesa të veçanta financiare të punonjësve të minierave, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", të ndryshuar, pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave, të caktuara me ligjin nr.150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", pensionet suplementare të caktuara sipas ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të

PENSIONET

1. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr.150/2014, që kanë datë fillimi të së drejtës deri më 31.12.2014, pas datës 1.4.2019 nuk do të jenë më pak se 13 753 lekë në muaj dhe më shumë se 27 506 lekë në muaj.

2. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.12.2014, pas datës 1.4.2019 nuk do të jenë më pak se 9 418 lekë në muaj, por jo më shumë se 13 753 lekë në muaj.

3. Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.4.2019 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 13 753 lekë në muaj.

universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë". Në pikën dy të vendimit të

Këshillit të Ministrave përcaktohet se indeksimin e pensionit e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.4.2019 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.3.2019, përfshirë edhe këtë datë.

Ulja e euroizimit të ekonomisë, BSH: Të kontribuojnë të gjitha palët

Rreth një vit më parë, Banka e Shqipërisë prezantoi strategjinë mbi zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin bankar dhe financiar, ose siç u quajt për thjeshtim komunikimi "strategjia e deeuroizimit". Kjo strategji synon uljen nivelit shumë të lartë të përdorimit të euros në ekonominë shqiptare. Banka e Shqipërisë kryen monitorime periodike të treguesve që preken nga strategjia e deeuroizimit. Analiza e fundit e muajit shkurt tregoi se pesha e depozitave në euro mbetet e lartë, por ndërkohë rezultatet janë më pozitive për sa i takon kreditimit, që është më i orientuar drejt lekut. Drejtori i Departamentit të Stabilitetit Financiar në Bankën e Sh-

qipërisë, Klodian Shehu, thotë për "Scan" se objektivat e strategjisë janë afatgjata dhe nuk priteshin ndryshime rrënjësore qysh në këtë fazë. Ai thekson se ulja e përdorimit të euros është e rëndësishme për të përmirësuar mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, por edhe për të ulur rrezikun e kursit të këmbimit për familjet dhe bizneset shqiptare. Mbështetur në Memorandumin bashkëpunimit të nënshkruar një vit më parë pritej që masa për uljen e euroizimit të ndërmerreshin edhe nga palët e tjera nënshkruese, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Megjithatë, deri tani këto institucione nuk kanë marrë masa konkrete. Në raportin e fundit për Shqipërinë, Fondi

Monetar Ndërkombëtar shprehej se strategjia e deeuroizimit duhet të mbështetet edhe nga qeveria, përmes masave administrative që do të nxisin kuotimin e çmimeve dhe kryerjen e pagesave në lekë për transakcione dhe brendshme në ekonomi. Për sa kohë që euro vazhdon të përdoret masivisht në ekonomi, edhe në rastet kur nuk është e nevojshme do të jetë e vështirë që monedha europiane të pakësohet brenda sistemit financiar. Që nga korriku i vitit të kaluar, Banka e Shqipërisë rriti nivelin e rezervës së detyrueshme për valutat dhe e uli atë për lekun. Rezerva e detyrueshme është përqindja e depozitave që çdo bankë duhet ta mbajë të papërdorura, në një llogari pranë bankës qendrore. Për depozitat në euro, niveli i rezervës së detyrueshme u



rrit nga 10% në 12.5%. Mbjajtja e bllokuar e më shumë depozitave sjell më shumë kosto për bankat, edhe duke pasur parasysh normat negative të interesit që aplikohen për rezervën e detyrueshme në euro. Në teori, kjo i bën bankat të kenë më shumë kosto nga depozitat në euro, duke i nxitur të rritin marzhet për kreditimin në euro, me qëllim komp-

ensimin e kostove shtesë. Paralelisht, rezerva e detyrueshme për lekun u ul nga 10% në 7.5% të totalit të depozitave. Ulja e rezervës së detyrueshme në lekë sjell kosto më të ulëta për ndërmjetësimin në monedhën vendase. Në teori, kjo lëvizje tenton t'i nxisë bankat të thithin më shumë depozita dhe të japin më shumë kredi në monedhën vendëse.

TIRANË - E pranishme në analizën vjetore të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, kryeprokurorja e përgjithshme e përkohshme, Arta Marku tha se 2018 ka qenë një vit i vështirë pune, por nuk harroi të 'shigjetonte' disa prokurorë që sipas saj nuk kanë qenë në lartësinë e detyrës. Ajo tha se duhet të hetohen sa më shpejt çështjet e nxehta që kanë trazuar jetën e vendit si nga ana e politikës ashtu edhe nga rastet kriminale. E para e prokurorisë u shpreh se shumë prokurorë në punën e tyre kanë nxjerrë sekretet hetimore dhe kjo ka vështirësuar në zbardhjen e rasteve komplekse, ndërsa apeloj që prokurorët të mbajnë larg mediat nga puna e tyre. Porositë e Markut drejtuar prokurorëve nuk

Kryeprokurorja, "shuplakë" edhe vartësve të Prokurorisë së Tiranës

Marku, prokurorëve të Krimeve të Rënda: Po na turpëroni, nxorët informacionet e dosjeve

kishin të bënin vetëm me rastet kriminale dhe politike, por ajo tha se duhet të nisin me urgjencë hetime të tjera intensive pasurore për çdo rast të dyshimtë. "Prokurori e Krimeve të Rënda është më e rëndësishmja në vend për shkak të kompetencave të saj lëndore. Kjo vëmendje e shtuar për hir të së vërtetës rrit presionin në punën tuaj. Ka qenë një vit shumë i ngarkuar, prokurorët disa prej jush, keni treguar se dini të punoni, por gjatë këtij viti disa prokurorë na kanë bërë

të na vijë turp që jemi prokurorë. Kanë nxjerrë sekrete hetimore. Disa kanë harruar të bëjnë hetime proaktive që duhej të bënin. Ju jeni prokurorë si gjithë të tjetër, por keni patur fatin të punoni në këtë prokurori. Të hetohen sa më shpejt çështjet që kanë trazuar jetën dhe kanë tronditur kryeqytetin. Fokusohuni tek puna dhe mbani larg median nga hetimi, gazetaret nuk janë pjesë e hetuesve. Mos lini pas dore hetimet pasurore. Krimi dhe korrupsioni duhen hetuar

çdo ditë. Falënderoj të gjitha ata që kanë punuar me përkushtim, suksese në punë dhe në procesin e vetingut", tha Marku. Kjo e fundit ka qenë e pranishme dhe në analizën e prokurorisë së Tiranës dhe asaj të Apelit.

Gjatë fjalës së saj, Marku nuk i kursou kritikat ndërsa theksin e ndali tek hetimet e shpejta dhe të pandikuara që duhet të bëjnë prokurorët. "Në prokurorinë e Tiranës ngarkesa ka qenë më e madhe dhe si duket kjo ka ulur cilësinë dhe efektivitetin në



Kryeprokurorja e përgjithshme e përkohshme, Arta Marku, gjatë analizës së djeshme

punë. Nuk jeni përqendruar në çështje sa duhet. Çështje mjaft të rëndësishme janë zvarritur pa justifikim, rrinë në sirtare prej vitesh me një mungesë të theksuar përgjegjësie. Vërehen hetime të pakta dhe jo të suksesshme, kjo

është përgjegjësi e secilit prej jush, përgjegjësi individuale. Kërkoj veçanërisht që të hetoni shpejt ato çështje ku ka vëmendje të shtuar nga opinioni publik. Ushtroini detyrën tuaj larg çdo ndikimi politik", - tha ajo.

Ngjarja në fshatin Grudë, gjykata lë në burg tre bashkëpunëtorët

Vrasja e "Nardit të Bujtinave", zbulohet emri i autorit që u arratis në Mal të Zi

Kristjan Sulaj është vëllai i të arrestuarit Alfred Martini, ka ndryshuar gjeneralitetet

SHKODËR

Gjykata e Shkodrës ka dhënë dje masën e sigurisë "Arrest me burg" për tre personat që u arrestuan tri ditë më parë, të cilët dyshohen si bashkëpunëtorë të autorit në vrasjen e Nard Polisë apo siç njihet ndryshe si "Nardi i Bujtinave". Bëhet fjalë për shtetasit: Gilbert Toma, Kleandro Toma dhe Alfred Martini. Ndërkohë, policia ka bërë të mundur identifikimin e autorit të dyshuar të vrasjes. Bëhet fjalë për së 36-vjeçarin, Kristjan Sulaj, i cili është vëllai i Alfred Martinit, por ka ndryshuar mbiemrin. Autori kryesor i vrasjes dyshohet se ka kaluar nga pika kufitare e Muriqanit dhe është arratisur nga Shkodra. Dy ditë më parë ata kanë mohuar akuzat ndaj tyre në policinë e Shkodrës. Sipas policisë, të tre të arrestuarit kanë ndihmuar ekzekutorin e Nard Polisë me municione luftarake si dhe i kanë ofruar strehim. Dy vëllezërit Toma janë shprehur se i kanë dhënë makinën tip "Audi" vëllezërve Martinit, ndërsa këta të fundit pretendojnë të kundërtën. Nga ana tjetër hetimet vijojnë intensivisht për zbardhjen e plotë të ngjarjes së rëndë ku mbeti i vdekur biznesmeni Nard Polia.

VRASJA E BIZNESMENIT

Ferdinand Polia, ishte një prej promotorëve të turizmit malor në zonën e Thethit. 32-vjeçari u ekzekutua të mërkurën e kaluar me 18 plumb në momentin kur ndodhej në fshatin Grudë, ku kishte dërguar fuoristradën e tij në një servis. Autori i dyshuar K.S., 29 vjeç, e qëlloi atë me breshëri të një arme amerikane "Tompson", pasi i preu rrugën me motor. Pasi zbriti qetësisht nga motori "T Max", 29-vjeçari qëlloi me breshëri ndaj Polisë, duke e lënë të vdekur në vend. Në makinë bashkë me 32-vjeçarin e vrarë ndodhej dhe një prej punonjësve të



32-vjeçari i vrarë, Ferdinand Polia



Të arrestuarit për vrasjen

ATENTATORI

Kristjan Sulaj (Martini) është personi që sipas policisë së Shkodrës ka vrarë një javë më parë biznesmenin e njohur nga Thethi, Ferdinand Polia, i njohur ndryshe si "Nardi i Bujtinave". Autori, i cili është ende në kërkim e që dyshohet se është arratisur përmes Muriqanit në Malin e Zi është vëllai i Alfred Martinit, i cili u arrestua para tri ditësh së bashku me dy vëllezërit Toma, që akuzohen si bashkëpunëtorë në krimin e rëndë.

servisit. Nisur nga rrethanat e ngjarjes, Nard Polia nuk ruhej aspak, pasi ai nuk ka bërë asnjë veprim për t'u mbrojtur dhe gjithçka i ka ardhur në mënyrë të papritur. 32-vjeçari ka jetuar deri para 4 vitesh në Itali. Në vendin fqinj ai është arrestuar nga policia në vitin 2010, me akuzën e trafikimit të drogës, shfrytëzimit të prostitucionit dhe vjedhjes me dhunë. Bashkë me të u arrestuan dhe disa shqiptarë të tjerë. Polia rezultoi se është dënuar me 4 vite heqje lirie dhe në përfundim të burgut është dënuar nga autoritetet për në Shqipëri. Pas kthimit në vendin e tij të lindjes, Nard Polia nisi të investojë në turizëm, si dhe u bë pjesë e administratës për Zonat e Mbrojtura, detyrë që e mban të deri në ditën e vrasjes.

Vëllezërit indianë Nitin dhe Chetan Sandesara, tashmë të larguar nga Shqipëria, por të shpallur në kërkim nga autoritetet indiane për krijimin e një skeme gjigande mashtrimi financiar, pretendojnë se agjencitë e qeverisë së Indisë e kanë nisur hetimin ndaj kompanive të tyre vetëm për qëllime politike. Përmes një reagimi të shpërndarë për mediat në Shqipëri, Sandesara Group thekson se asnjë nga pretendimet e qeverisë indiane nuk është provuar në gjykatë. Grupi Sandesara thekson gjithashtu se themeluesit Nitin e Chetan Sandesara kanë kontribuar shuma të mëdha parash në bamirësi, në vende të ndryshme. "Grupi Sandesara ka vlerë neto prej më shumë se 10 miliardë dollarë dhe punëson më shumë se 15,000 pro-

Akuzat, 'Sandesara': Hetimi në vitin 2017, u provua se ishte politik



fesionistë në mbarë botën. Z. Nitin Sandesara dhe Z. Chetan Sandesara, gjithashtu, kanë kontribuar shuma të mëdha parash në bamirësi në vende të ndryshme. Z. Nitin Sandesara është nderuar nga

qeveritë e ndryshme dhe ka një rrugë në emër të tij në Virxhinia, SHBA si "Sandesara Drive", thuhet në deklaratën e grupit ku sqarohet më tej një hetim i nisur në vitin 2017. "Në vitin 2017 ekzistonte një hetim i dyshimtë për mashtrimet e bankare për kompanitë tona indiane, të hetura nga agjencitë e Qeverisë së Indisë vetëm për qëllime politike. Ky mashtrim bankar i dyshuar gjithashtu është cilësuar si pastrim parash. Këto janë të gjitha pretendimet dashakeqe, dhe asgjë nuk është provuar në gjykatë dhe në fakt të gjitha këto akuzat janë kontestuar nga grupi Sandesara në

gjykata të ndryshme në Indi. Përkundrazi, gjykatat ndërkombëtare kanë konsideruar tashmë se këto veprime të agjencive indiane janë të gjitha të motivuara politikisht dhe transakcionet e thjeshta komerciale janë shtrembëruar duke u quajtur si mashtrime bankare edhe pse bankat janë paguar shumë më tepër para se kredia dhe përveç kësaj kur bankat po mbajnë gjithashtu kolateralin e në shumë se një miliard dollar aktiveve të grupit Sandesara në Indi", - thuhet në deklaratë, sipas së cilët institucionet ndërkombëtare kanë përcaktuar këto veprime të Indisë si të motivuara politikisht.

TIRANË - Prokuroria e Krimeve të Rënda ka zgjatur hetimet për ish-kryeprokurorin Adriatik Lllalla edhe me tre muaj të tjerë. Hetimet për Lllallën nisën më 1 mars 2018 për akuzat e "fshehjes së pasurisë", "mosdeklarimin e të hollave në kufi", "pastrim parash" dhe "shpërdorim të detyrës". Nga ana tjetër, ai më 25 mars ka bërë ankim në gjykatën e shkallës së parë



Ish-kryeprokurori, Adriatik Lllalla

Akuza për pastrim parash, zgjaten me 3 muaj të tjerë hetimet për Adriatik Lllallën

kundër zgjatjes së afatit të hetimit, duke e konsideruar të padrejtë vendimin. Kërkesa e ish-kryeprokurorit pritet të shqyrtohet nga gjyqtari Bibë Ndreca. Por, edhe pse tashmë Lllalla ka një betejë të hapur me drejtësinë shqiptare, nga ana tjetër ai ka nisur punën duke punësuar

edhe dy lobistë, me qëllim që të largohet nga lista e personave të padëshiruar, i shpallur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Figura e Adriatik Lllallës ka qenë etiketuar shumë nga ish-ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Donald Lu, teksa nuk ngurroi ta sul-

monte si i përfshirë në korrupsion. Ndërkohë, Adriatik Lllalla i ka hedhur poshtë në mënyrë kategorike akuzat, ndërsa pretendimet e Lu-së i ka quajtur veprime tinëzare dhe të pabazuara, duke shtuar se ai po bën rolin e gjykatësit dhe të prokurorit.

"Kur do i marrim lekët"? Përgjimet nxjerrin zbuluar 4 autorët e krimit

Ekzekutimi i biznesmenit Jurgen Kurti, identifikohet atentatori Klodian Bane

Policia: "Benz"-i me targa false çoi në zbulimin e autorit të vrasjes, që është në kërkim



TIRANË

Një ditë pas arrestimit të tre të rinjve të dyshuar si bashkëpunëtorë në ekzekutimin e menaxherit të VIP-ve, Jurgen Kurti, burime nga policia bënë me dije se dyshohet që Klodian Bane është autori i vrasjes së 26-vjeçarit. Një javë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në rrugën "Zef Jubani" në kryeqytet, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me lëvizjet e ekzekutorit dhe se si arriti policia ta identifikonte atë. Mësohet se ditën e ngjarjes (më 18 mars), automjeti tip "Benz" ngjyrë gri, me të cilin iu bë atentat biznesmenit Jurgen Kurti, atentatori Klodian Bane i ka mbivendosur targa false. Pas ngjarjes, mjeti është ndjekur nga kamerat e sigurisë dhe është kapur duke u futur në një rrugicë ku ka hequr targa false për të vijuar të qarkullojë me targa të veta. Ishte pikërisht ky detaj, që ndihmoi policinë të identifikonte pronarin e mjedit dhe më pas tre miqtë e tij, tashmë të arrestuar: Elsi Levendi lindur në Athinë/Greqi dhe banues në Tiranë, Olsi Qalliaj 22 vjeç, lindur në Fier dhe banues në Patos dhe Alesio Berberi 33 vjeç lindur në Patos dhe banues në Patos, Fier. Sipas burimeve të mësipërme, autorët e krimit janë zbuluar edhe nga përgjimet. Dyshohet se Levendi, Berberi, Qalliaj dhe personi i shpallur në kërkim, Klodian Bane janë paguar për të kryer atentatin ndaj Kurtit. Ndërsa, porositisit mbeten ende enigmë.

ROLET NË GRUP

Ditën e vrasjes, pranë banesës së Kurtit qëndronte personi që e ndiqte në këmbë, 21-vjeçari Elsi Levendi. Edhe momentin e vrasjes, 21-vjeçari ka qenë i pranishëm në zonë dhe dyshohet se ai ka njoftuar ekzekutorët për mbërritjen e Kurtit pranë pallatit. Nga këqyrja e kamerave të sigurisë në zonë, policia ka ndjekur lëvizjet e 21-vjeçarit dhe të makinës dhe është parë se pas atentatit ata janë takuar. Pas identifikimit të personave, ata janë vënë në përgjim dhe janë arrestuar. Arma, makina dhe sendet e tjera të sekuestruara nga policia janë gjetur në banesën e Alesio Berberit. Të 3 të arrestuarit kanë mbajtur qëndrim mohues para policisë dhe nuk kanë pranuar përfshirjen në këtë ngjarje. Ata rezultojnë të jenë me ar-



Viktima Jurgen Kurti



Vendi ku ndodhi vrasja e biznesmenit

50 ▶

KAMERA

Për të identifikuar të arrestuarit, policia ka grumbulluar mbi 50 kamera sigurie nga liçeni deri tek "Pallati me Shigjeta", nga ku ka zbuluar 4 të rinjtë dhe lidhjen mes tyre. Në drejtim të mjedit ka qenë i shpallur në kërkim, ndërsa pranë banesës së Kurtit dhe personi që e ndiqte në këmbë ka qenë 21-vjeçari Elsi Levendi. Edhe momentin e vrasjes 21-vjeçari ka qenë i pranishëm në zonë dhe dyshohet se ai ka njoftuar ekzekutorët për mbërritjen e Kurtit pranë pallatit.

MOHIMI I AKUZAVE

Arma, makina dhe sendet e tjera të sekuestruara nga policia janë gjetur në banesën e Alesio Berberit. Të 3 të arrestuarit kanë mbajtur qëndrim mohues para policisë dhe nuk e kanë pranuar përfshirjen në këtë ngjarje. Ata rezultojnë të jenë me arsim 8 dhe 9-vjeçar dhe të papunë, çka rriten edhe më tej dyshimet për veprimtarinë e tyre. Policia ende nuk ka një motiv për ngjarjen që ka çuar në vrasjen e Jurgen Kurtit, i njohur ndryshe si "Menaxheri i VIP-ve".

sim 8 dhe 9-vjeçar dhe të papunë, çka rriten edhe më tej dyshimet për veprimtarinë e tyre.

ARRESTIMI I AUTORËVE

Tre personat e përfshirë në vrasjen e menaxherit të VIP-ve janë arrestuar në Tiranë të martën duke udhëtuar me makinë. Në polici ata nuk i kanë pranuar akuzat dhe nuk kanë dhënë detaje. Të rinjtë e kanë ndjekur për disa ditë Jurgen Kurtin dhe janë kapur nga

kamerat e sigurisë duke udhëtuar me mjedin "Benz" që u përdor edhe ditën e vrasjes. Policia deklaroi më herët se gjatë kontrollit fizik dhe në banesat e këtyre shtetasve gjeti dhe sekuestroi një automjet që u ka shërbyer autorëve për t'u larguar nga vendi i ngjarjes, si dhe dy makina të tjera luksoze. Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale edhe një armë zjarri pisto-

letë tip "TT", fishekë luftarakë, një sasi prej 2470 euro e lekë shqiptare, 13 aparate celular, si dhe një sasi e vogël lënde markitike.

PËRGJIMET E GRUPIT

Ndërkaq, mësohet se gjatë kohës që të rinjtë ishin në përgjim, ata kanë folur me njëri-tjetrin për një shumë parash që do të merrnin për "punën" e kryer: "Ke folur për ato lekët"? "Kur do i marrim ato lekët"? Janë këto disa prej bisedave të përgjuara mes tyre.



Vrasja e Ravik Gurrës, avokatët në Shkodër, Lushnjë, Berat e Durrës, bojkot punës për 3 ditë

Pas Elbasanit e Korçës, edhe avokatët e Shkodrës, Lushnjës, Beratit dhe Durrësit janë solidarizuar me kolegët duke protestuar pas vrasjes së avokatit të njohur Ravik Gurrës. Ata kanë marrë vendimin të bojkotojnë për 3 ditë proceset gjyqësore. Avokatët e Shkodrës u mbledhën në një nga sallat e gjyqit në gjykatën e këtij rrethi dhe mbajtën 1 minutë heshtje në nderim të kolegut të tyre, avokatit Ravik Gura, i cili u ekzekutua disa ditë më parë në qendër të qytetit të Elbasanit. Sekretarja e Dhomës së Avokatisë në Shkodër, Laureta Vathaj, tha se misioni i avokatit është fisnik dhe nuk duhet të jetë i rrezikuar. Ditën e sotme u zhvilluan seancat gjyqësore vetëm për masat e sigurisë, ndërsa të tjerat u shtynë pas bojkotit të avokatëve mbrojtës. Të njëjtin vendim morën dje edhe avokatët e Lushnjës dhe Beratit, përveç masave të sigurimit. Ky vendim vjen si solidarizim me të gjithë avokatët e Shqipërisë. Kryetari i Dhomës së Avokatisë Berat, Agron Mahmutaj ka deklaruar se Dhoma e Avokatisë Berat do të përkrahë dhe solidarizohet me vendimin e ndërmarrë nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë disa ditë më parë. Sipas Mahmutajt, me vrasjen e avokatit Ravik Gurrës është në rrezik institucioni i avokatit dhe të gjithë avokatët në vend ndihen të kërcënuar për jetë e tyre. "Akt shumë i rëndë, që nuk pranohet për cilindo qytetar jo më për një avokat. Avokatët kanë një mision shumë të shenjtë, misionin që të mbrojnë qytetarët nga padrejtësitë dhe në fund ndodh që të përfundojnë vetë në padrejtësi të tilla", tha avokati Gramoz Lika nga Durrësi. Sipas tij, vrasja e kolegut Gurrës tregon që shteti nuk e ka kryer detyrën, ndaj edhe bojkoti vjen si një thirrje për më shumë siguri ndaj drejtësisë të shtetit. Lika tha se avokatët e Durrësit janë në pritje të vendimit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe asaj të qytetit bregdetar në lidhje me këtë çështje. Viktima Gurrës, që njihet për mbrojtjen e çështjeve të bujshme si ajo e Çapjavë dhe Shullazit, ka qenë i ulur në ambientet e një lokali jashtë kur është qëlluar me dy plumbas pas koke. Ai ishte i shoqëruar me dy persona të tjerë në tavolinë, njëri prej tyre gjithashtu avokat.

SIGURIMI I FERMERËVE KRITERET

"Procedura që duhet ndjekur për ata që nuk i kanë paguar kontributet e në të kaluarën"

Voltiza Duro

Përfshirja në skemën e sigurimeve shoqërore do të sjellë një sërë përfitimesh për fermerët që ushtrojnë aktivitetin e tyre bujqësor apo blegtoral. Instituti i Sigurimeve Shoqërore thekson se nga ky sigurim fermerët mund të përfitojnë pension, kompensimin e çmimit të barnave në rast sëmundjesh si dhe vizita mjekësore falas. "Të nderuar fermerë! Sigurimi në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Ju që ushtroni aktivitetin bujqësor dhe blegtoral, është investimi më i mirë që mund të bëni për veten dhe familjarët tuaj. Nga ky sigurim Ju përfitoni: pension pleqërie; pension invaliditeti; pension familjar për fëmijët tuaj; sigurim për barrë lindjen për nënat e reja; vizitën mjekësore pa pagesë dhe kompensimin e çmimit të barnave mjekësore në rast sëmundjeje. Mos humbisi kohë, mendoni për të ardhmen tuaj!", -bën me dije ISSH.

KRITERET

Bazuar në ligjin "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", personi që futet në skemën e detyruar të sigurimit shoqëror për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësojë disa kriteret. Individit duhet të ketë mbushur moshën 16 vjeç; të jetë i/e aftë për punë; dhe të mos jetë i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë. Gjithashtu, i vetëpunësuar në bujqësi duhet të banojë në të njëjtin rreth ku ka tokën bujqësore në pronësi ose në përdorim, dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore e blegtorale. Gjithashtu, ai edhe mund të banojë në fshat dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore dhe blegtorale, megjithëse tokën mund ta ketë në rrethin fqinjë. Vlen të theksohet se ka të drejtë të sigurohet çdo person deri në mbushjen e moshës për të dalë në pension.

KONTRIBUTET

Instituti i Sigurimeve Shoqërore thotë se sigurimi si i/e vetëpunësuar në bujqësi është i detyrueshëm dhe ky i/e vetëpunësuar/a, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogarit mbi bazën e masës vjetore prej 38 400 lekësh. "Ndërkohë, i/e vetëpunë-

Sigurimi i fermerëve, ISSH: Cilat janë 3 përfitimet që mund të keni

Sa duhet të paguajnë të vetëpunësuarit në bujqësi, afatet



PAGESA

"Ndërkohë, i/e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim paguan kontributet për sigurimet shoqërore kundrejt detyrimit tremujor, të llogarit mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh", - thekson ISSH.

KONTRIBUTET TË PAPAGUARA

ISSH thekson se të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, por që i kanë pasur kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga vendbanimi aktual, mund t'i paguajnë kontributet për këto periudha sipas masës së kontributit.

suari/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogarit mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh. PAGESAT E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE BËHEN BASHKËRISHT. Ato janë të detyrueshme dhe paguhen individualisht një herë në tre muaj", - thekson ISSH. Sakaq, afati i fundit i këtyre pagesave është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik. Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për vitin në vazhdim, pavarësisht nëse janë të pasiguar për vitet pararendëse. Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen si periudha sigurimi. Ndërkohë të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kushtin minimal të vjetërsisë në punë, për të

përfituar pension të pjesshëm, mund të kryejnë pagesa kontributesh pas plotësimit të moshës për pension, por me kusht që ato t'u korrespondojnë periudhave para plotësimit të moshës për pension dhe të mos jetë caktuar ende asnjë lloj pensioni dhe për këto periudha do të paguhet sipas masës së kontributit. ISSH thekson se të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, por që i kanë pasur kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga vendbanimi aktual, mund t'i paguajnë kontributet për këto periudha sipas masës së kontributit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin kur kryhet pagesa.

PËRFITIMET

Personat e vetëpunësuar në bujqësi që përshihen në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore mund të përfitojnë nga kuotat e

ultat të pagesave të kontributiveve. "Për një vit vjetërsie në punë në shtet një i/e vetëpunësuar në qytet paguan 66240 lekë, ndërsa: a) I/e vetëpunësuar/a në zonat fushore paguan 38 400 lekë në vit; b) I/e vetëpunësuar/a në zonat malore paguan vetëm 29 400 lekë në vit", - nënvizon ISSH. Por fermerët e vetësiguruar marrin edhe përfitim të vjetërsisë në punë, ku njihja e periudhave për të cilat janë paguar kontributet njihet vjetërsi në marrëdhënie pune me shtetin. "I/e vetëpunësuar/a në bujqësi, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, është përfitues/e, sipas rasisit, i/e: pensionit bazë të pleqërisë; pensionit të pjesshëm të pleqërisë; pensionit të invaliditetit; pensionit të familjar; shpërblimit për lindje fëmijë", -bën me dije Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

SIGURIMI SHOQËROR

Kushtet për t'u siguruar

Personi që futet në skemën e detyruar të sigurimit shoqëror për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të ketë mbushur moshën 16 vjeç;
2. Të jetë i/e aftë për punë;
3. Çdo person mund të sigurohet deri në mbushjen e moshës për pension;
4. Nuk duhet të jetë i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë;
5. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi duhet:
 - Të banojë në të njëjtin rreth ku ka tokën bujqësore në pronësi ose në përdorim, dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore e blegtorale;
 - Të banojë në fshat dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore dhe blegtorale, megjithëse tokën mund ta ketë në rrethin fqinjë.

Pagesat e kontributeve

1. Sigurimi si i/e vetëpunësuar në bujqësi është i detyrueshëm.
2. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogarit mbi bazën e masës vjetore prej 38 400 lekësh.
3. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogarit mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh.
4. PAGESAT E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE BËHEN BASHKËRISHT. Ato janë të detyrueshme dhe paguhen individualisht një herë në tre muaj.
5. Afati i fundit i këtyre pagesave është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

Dokumentacioni

1. I/e vetëpunësuar/a në bujqësi paraqet tek inspektori përkatës i sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi këto dokumente:
 - Vërtetimin e pronësisë mbi tokën, dhe / ose Vërtetimin mbi tokën e marrë në përdorim, dhe / ose Kontratën e qiramarrjes së tokës bujqësore, të notuarizuar;
 - 2. Inspektori i të vetëpunësuarve në bujqësi, pasi gjykon për plotësimin e kushteve për sigurim si i/e vetëpunësuar në bujqësi plotëson dokumentin tip "Urdhër veprim" dhe ia jep fermerit;
 - 3. Për të bërë pagesën paraqitet ky dokument në zyrën postare ose në zyrën bankare. Me kryerjen e pagesës zyra postare lëshon dokumentin "Mandat arkëtimi", ndërsa me kryerjen e pagesës në zyrën bankare lëshohet dokumenti "Veprim arke", i cili konfirmon kryerjen e kësaj pagese;
 - 4. Me dokumentin "Mandat arkëtimi" ose "Veprim arke" fermeri paraqitet për regjistrim tek inspektori i sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi, ku ka marrë "Urdhër veprimin";
 - 5. Këto dokumente në asnjë rast nuk duhet t'i dorëzohen punonjësit të sigurimeve shoqërore. Ato janë personale;
 - 6. Në fund të procedurës dhe pas pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore bëhet pajisja e detyrueshme me librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
 - 7. Me kërkesën e të vetëpunësuarit në bujqësi ai pajiset nga organet e sigurimeve shoqërore edhe me vërtetimin tip "Për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore"



SISTEMI I DEGRADUAR

"BIZNES I PISËT"

"Sistemi farmaceutik ka degraduar dhe ndodhet në ato limite që nëse nuk vendosen rregullatorët dhe ligjet për funksionim normal, mendoj nuk do kemi më 'profesion', por do kthehet në një biznes të pisët të depove dhe personave, që nuk kanë lidhje fare me farmacinë e hapin rrjete farmaceutike me konkurrencë të papastër", - thotë farmacisti.



EVAZION FISKAL

DEKLARIME TË PAVERTETA

"Në të gjitha vendet e BE-së me ligj është e ndaluar hapja e farmacive nga depot. Po shkojmë drejt krijimit të monopolit të tregut, ku gjithçka është në dorë të pesë grosistëve që fitojnë në depot e tyre 500 për qind në çdo medikament që importojnë, por e deklarojnë vetëm 5% dhe bëjnë këtë evazion të tmerrshëm fiskal", - thotë një tjetër farmacist.



BLERJA E FARMACIVE

"JEMI TË PUNËSUAR"

"Dalëngadalë këta shpërndarës do të blejnë të gjitha farmacitë dhe farmacistët. Edhe realisht ne të punësuarit e tyre jemi përdërisa tregtojmë medikamentet e tyre, thjesht paguajmë qirarë e objekteve se të tjerat nuk llogariten", - shprehet një farmacist i pavarur.

Kryeinspektori i UFSH-së: Mund të bëjnë manovra edhe me çmimet e medikamenteve

Depot farmaceutike krijojnë rrjete, rrezik falimentimi rreth 80% e farmacive autonome

Dëfrim Goma: Mund të marrin edhe rimbursimin e barnave

Voltiza Duro

Depot farmaceutike në vendin tonë kanë filluar të hapin vetë farmacitë e tyre, madje të krijojnë edhe rrjete farmacish. Kjo veprimtari e dyfishtë, e ndaluar me ligj në shumë vende të rajonit, por e lejuar në Shqipëri, ka alarmuar një pjesë shumë të madhe të farmacistëve autonomë. Këta të fundit shprehen tejet të shqetësuar pasi rrezikojnë falimentimin për një sërë faktorësh. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Dëfrim Goma, kryeinspektor i Mbikëqyrjes Profesionale pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë sqaron të gjitha pasojat që mund të sjellë kjo konkurrencë e pandershme nga ana e depove farmaceutike. Ai shton se këto depo mund të krijojnë një rrjet e të bashkëpunojnë vetëm me njëri-tjetrin, duke lënë pa barna farmacitë autonome. Sipas Gomës, rreziku potencial më i madh qëndron në faktin që këto depo farmaceutike që hapin edhe farmaci, mund të marrin ndonjë koncesion për barnat e rimbursueshme, çka do të nxirrte jashtë loje farmacitë e tjera në vend.



Kryeinspektori i Mbikëqyrjes Profesionale pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, Dëfrim Goma



si farmaci?

Një rrezik potencial është edhe marrja e rimbursimit të barnave. Pra, depot farmaceutike krijojnë në fillim bazën logjistike, sepse në fillim po blejnë farmacitë ekzistuese. Tendencat është që t'i marrë me koncesion ky rrjet. Si pasojë farmacitë e tjera në mënyrë absolute do të shkojnë drejt falimentimit.

A keni bërë ndonjë kërkesë pranë instancave përkatëse për të ndaluar këtë veprimtari të dyfishtë nga ana e depove farmaceutike?

Ne si UFSH, kemi kërkuar dhe do të vazhdojmë të kërkojmë që të ndërhyhet urgjentisht në ligj dhe të ndalohen me ligj rrjetet farmaceutike, qoftë nga depot, qoftë nga prodhuesit. Në Itali, Slloveni, Kroaci, Maqedoni etj është e ndaluar me ligj që depot farmaceutike të hapin farmaci. Nëse nuk merren masa, kjo cenon drejtpërdrejt konkurrencën e ndershme. Dua të theksoj edhe njëherë se farmacitë që janë të pavarura, autonome, janë të rrezikuara deri në falimentim, pasi kjo është e gjitha operacioni financiar, jo në mirë të shërbimit, pra të falimentojnë rreth 80% e farmacive në vend dhe të ngelen vetëm depot me rrjetet e tyre.

RREZIKU

"Dua të theksoj edhe njëherë se farmacitë që janë të pavarura, autonome janë të rrezikuara deri në falimentim, pasi ky është i gjithi operacioni financiar jo në mirë të shërbimit. Pra, të falimentojnë rreth 80% e farmacive në vend dhe të ngelen vetëm depot me rrjetet e tyre", - thotë Goma.

kumet ligjore, disa depo farmaceutike, nuk hapën vetëm disa farmaci, por një rrjet farmacish.

A do të sjellë kjo një monopolizim të sistemit farmaceutik në Shqipëri?

Ky është monopolizimi i sistemit farmaceutik në vend, pasi depot farmaceutike në këtë mënyrë shesin edhe me shumicë, por mund të ketë edhe një numër të caktuar barnash që i disponon vetëm kjo depo. Kështu rrjedhimisht krijohet monopoli, sepse kjo

depo, me këto barna furnizon vetëm farmacinë e tij, ose nëse krijon 2-3 rrjete (2-3 depo) bën të njëjtën gjë, bëjnë një bashkëpunim me marrëveshjen që do të furnizojnë vetëm njëri-tjetrin.

Sa do të ndikojë kjo në punën e farmacive të tjera?

Ky proces do të pengojë punën e farmacive të tjera, pasi qoftë edhe një ditë ta pengosh një farmaci me një furnizim. Kuptohet që pacienti, medikamentin që

kërkon nuk do ta gjejë të të gjitha farmacitë, por vetëm të farmacitë e këtyre depove farmaceutike. Kështu që mund të humbasin edhe klientët. Rreth 99% e farmacistëve të pavarur janë kundër kësaj veprimtarie nga ana e depove.

A mund të bëhen manovra nga këto depo farmaceutike mbi çmimet e barnave?

Depot farmaceutike që hapin edhe farmaci, kanë mundësinë që të bëjnë edhe skonto në çmimet e

"Depot farmaceutike që hapin edhe farmaci kanë mundësinë që të bëjnë edhe skonto në çmimet e barnave, pavarësisht se barnat kanë një pullë. Por mund të luhet edhe me këtë pjesën e çmimeve", - sqaron Goma.

barnave, pavarësisht se barnat kanë një pullë. Por mund të luhet edhe me këtë pjesën e çmimeve.

Sa të rrezikuara janë farmacitë nga falimentimi, në një kohë që në treg depot do të operojnë edhe

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Palli 64, Hyrja B, Ap. 1, Tiranë, njofton se më datë 25.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme, Apartament me sipërfaqe totale 86.35 m², me numër pasurie 2/139/NDV-1-13, volumi 71, faqe 142, zona kadastrale 8516, me adresë Lagja 13, Plazh, Hyrja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z.Çlirim Sejfulla Xhafa dhe Z.Çlirim Xhafa Xhafa me vlerë fillestare në ankand 20,454.84 (Njëzet mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër pikë tërthorë) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
Rr. "Fah Dalia", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Nr. 1, Tiranë
Web: www.3h.al Email: shqg_3h@yahoo.com tel: 0692202711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.26.03.2019 deri ne dt. 04.04.2019 per: sendin e luajtshem mjete me targe DR 9619 D ne pronesi te Hysni Gjergji

Cmimi fillestar eshte 560 EURO

Ankandi zhvillohet ne zyren perbarimore ne daten 04.04.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dytë për pasurinë: 1- Njesi, me sipërfaqe 64.10 m², e ndodhur në Lagja Bankade, Berat, në Zonën Kadastrale 8501, Numri i Pasurisë: 8/147-N1. Vol. 22, Faqe. 87. Në pronësi të Dorjana Gjovreni,Erndit Gjovreni,Beshir Gjovreni. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 4,953,648 (kater milion e nentëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) LEKE.

Ankandi i dytë për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 19.04.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbarueses gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 069381883 .

BalkanWeb.com

**AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.**



**MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET**



**INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID**

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Kush do të punësohet në pozicionin mami, fizioterapi, teknik imazherie e laboratorit

Zbardhen emrat e 660 punonjësve të shëndetësisë, që do të punojnë në shtet

Listat e plota të fituesve për të gjitha qarqet

Të gjithë ata që kanë konkurruar për një vend pune si punonjës të shkencave mjekësore teknike në portalin "Infermierë për Shqipërinë", mund të verifikojnë nëse kanë arritur të shpallen fitues. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listat me emrat e 660 aplikantëve të kualifikuar për të gjitha qarqet që do të kenë mundësinë të punësohen në shtet pas konkursit. Përkatesisht janë 220 fitues në pozicionin mami, 200 në fizioterapi, 148 në pozicionin teknik laboratorit dhe 88 në profi-



lin teknik imazherie. Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 493, datë 13.11.2017 "Për administrimin e procedurave të punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale publikon listat përfundimtare të aplikantëve të kualifikuar, që morën pjesë në konkursin për profesionistë të shkencave mjekësore teknike", - thekson Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Gjithashtu, bëhet me dije se në listë janë përfshirë edhe aplikantët që janë kualifikuar nga konkurset e mëparshme dhe që nuk janë punësuar akoma.

EMRAT ME 660 PUNONJËSIT E SHËNDETËSISË QE DO TË PUNOJNË NË SHTET

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
43	Greta	Pici	Tiranë	Mami	50.8
44	Esmeralda	Sulo	Tiranë	Mami	50.5
45	Romilda	Torollari	Tiranë	Mami	50.5
46	Driola	Kokomeci	Tiranë	Mami	50
47	Albina	Zaimi	Tiranë	Mami	49.9
48	Anita	Hazizaj	Tiranë	Mami	49.7
49	Enki	Dishani	Tiranë	Mami	49.5
50	Sonila	Xhoxhi	Tiranë	Mami	49.5
51	Erisa	Shaba	Tiranë	Mami	49.3
52	Marinela	Korçari	Tiranë	Mami	49.3
53	Ardita	Varangu	Tiranë	Mami	49.3
54	Griselda	Basha	Tiranë	Mami	49.3
55	Denisa	Hena	Tiranë	Mami	48.5
56	Lindita	Xhienhaj	Tiranë	Mami	48.5
57	Volteza	Midha	Tiranë	Mami	48.5
58	Blerina	Balla	Tiranë	Mami	48.5
59	Jerina	Toma	Tiranë	Mami	48.5
60	Albina	Doka	Tiranë	Mami	48.4
61	Merita	Sina	Tiranë	Mami	48.4
62	Fabiola	Lilo	Tiranë	Mami	48.4
63	Silda	Kola	Tiranë	Mami	48.3
64	Fjorida	Mollanji	Tiranë	Mami	47.9
65	Stela	Pano	Tiranë	Mami	47.7
66	Enada	Hoxhaj	Tiranë	Mami	47.4
67	Manjola	Kuçi	Tiranë	Mami	47
68	Kristina	Orci	Tiranë	Mami	46.9
69	Ola	Keci	Tiranë	Mami	46.8
70	Anila	Xhaferri	Tiranë	Mami	46.7
71	Realda	Biba	Tiranë	Mami	46.7
72	Arta	Deda	Tiranë	Mami	46.5
73	Leontina	Marku	Tiranë	Mami	46.5
74	Blerina	Xhaja	Tiranë	Mami	46.5
75	Lorena	Kadiu	Tiranë	Mami	46.4
76	Elvina	Lami	Tiranë	Mami	46.3
77	Olta	Dajti	Tiranë	Mami	45.9
78	Xhemile	Dolonaku	Tiranë	Mami	45.6
79	Migjena	Kadiu	Tiranë	Mami	45.5
80	Sonila	Alia	Tiranë	Mami	45.5
81	Anila	Xhaferri	Tiranë	Mami	45.3
82	Nensi	Lala	Tiranë	Mami	45.3
83	Erjona	Morina	Tiranë	Mami	45
84	Berije	Vasku	Tiranë	Mami	44.7
85	Brunilda	Lala	Tiranë	Mami	44.6
86	Enalda	Dollomaja	Tiranë	Mami	44.3
87	Elia	Xhaja	Tiranë	Mami	44.2
88	Greta	Kuka	Tiranë	Mami	44.2
89	Leonora	Gjoni	Tiranë	Mami	44.1
90	Miranda	Thaci	Tiranë	Mami	44.1
91	Elona	Hasa	Tiranë	Infermiere Mami	44
92	Neada	Zeçaj	Tiranë	Mami	44
93	Filmona	Profi (Salaj)	Tiranë	Mami	43.8
94	Elona	Priift	Tiranë	Mami	43.7
95	Edlira	Sida	Tiranë	Mami	43.6
96	Blerina	Carcu	Tiranë	Mami	43.4
97	Sonila	Ballabani	Tiranë	Mami	43.2
98	Jonida	Cani	Tiranë	Mami	42.9
99	Vanesa	Abazi	Tiranë	Infermier-Mami	42.6
100	Brunilda	Lala	Tiranë	Mami	41.9
101	Fabjola	Metkaj	Tiranë	Mami	41.5
102	Fjona	Pashollj	Tiranë	Mami	41.5
103	Fjoralda	Murati	Tiranë	Mami	41
104	Marsilda	Baxhia	Tiranë	Mami	40.4

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Megi	Xibraku	Elbasan	Teknik Laboratorit	75.2
2	Venemin	Gega	Elbasan	Teknik Laboratorit	63.6
3	Edvea	Sharra	Elbasan	Teknik Laboratorit	62.6
4	Xhoana	Jaho	Elbasan	Teknik Laboratorit	60.3
5	Marsela	Kanaci	Elbasan	Teknik Laboratorit	60
6	Enkelelda	Braçja	Elbasan	Teknik Laboratorit	59.6
7	Blerita	Budani	Elbasan	Teknik Laboratorit	58.9
8	Eriola	Kabashi	Elbasan	Teknik Laboratorit	57.1
9	Erandia	Haskja	Elbasan	Teknik Laboratorit	56.7
10	Xhuliana	Cakalli	Elbasan	Teknik Laboratorit	55.2
11	Evisa	Ranxha	Elbasan	Teknik Laboratorit	54.2
12	Aida	Gjini	Elbasan	Teknik Laboratorit	53.9
13	Olian	Beti	Elbasan	Teknik Laboratorit	51.9
14	Andela	Vaska	Elbasan	Teknik Laboratorit	51.6
15	Lira	Toli	Elbasan	Teknik Laboratorit	51.1
16	Elda	Ruci	Elbasan	Teknik Laboratorit	50.6
17	Alma	Xheka	Elbasan	Teknik Laboratorit	50.1
18	Diamantina	Malollari	Elbasan	Teknik Laboratorit	49.3
19	Mirela	Shgumi	Elbasan	Teknik Laboratorit	45.3
20	Rexhina	Hajrulla	Elbasan	Teknik Laboratorit	45.1
21	Emiselda	Menalla	Elbasan	Teknik Laboratorit	44.6
22	Andela	Vaska	Elbasan	Teknik Laboratorit	43.7
23	Enxhi	Isa	Elbasan	Teknik Laboratorit	43.4
24	Bronila	Zogolli	Elbasan	Teknik Laboratorit	42.7

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
43	Xhensila	Qemalaj	Tiranë	Teknik Laboratorit	57.4
44	Gerta	Çarku	Tiranë	Teknik Laboratorit	57.1
45	Anjeza	Lushllari	Tiranë	Teknik Laboratorit	57
46	Suela	Karriçi	Tiranë	Teknik Laboratorit	57
47	Aida	Gjini	Tiranë	Teknik Laboratorit	56.9
48	Enkelelda	Braçja	Tiranë	Teknik Laboratorit	56.6
49	Donika	Duka	Tiranë	Teknik Laboratorit	56.5
50	Erida	Mulgeci	Tiranë	Teknik Laboratorit	56.4
51	Marsida	Germani (Hodollari)	Tiranë	Teknik Laboratorit	56.4
52	Geraldina	Galo	Tiranë	Teknik Laboratorit	56.2
53	Maria	Mercuri	Tiranë	Teknik Laboratorit	56
54	Nera	Kapo	Tiranë	Teknik Laboratorit	55.5
55	Xhuliana	Çakalli	Tiranë	Teknik Laboratorit	55.2
56	Xhovana	Kocoli	Tiranë	Teknik Laboratorit	55.1
57	Dorjan	Çalliku	Tiranë	Teknik Laboratorit	54.3
58	Evisa	Ranxha	Tiranë	Teknik Laboratorit	54.2
59	Ilda	Cela	Tiranë	Teknik Laboratorit	54.2
60	Rahime	Sulko	Tiranë	Teknik Laboratorit	54.1
61	Borana	Kalemaj	Tiranë	Teknik Laboratorit	54
62	Enxhi	Dhamo	Tiranë	Teknik Laboratorit	53.2
63	Florian	Ibrahim	Tiranë	Teknik Laboratorit	52.8
64	Klemena	Rrodhe	Tiranë	Teknik Laboratorit	52.4
65	Kitarjona	Veizaj	Tiranë	Teknik Laboratorit	52.2

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Xhuljana	Maike	Vlorë	Teknik Laboratorit	63
2	Kleopatra	Pina	Vlorë	Teknik Laboratorit	61.6
3	Autona	Gjoni	Vlorë	Teknik Laboratorit	61.5
4	Panajota	Halli	Vlorë	Teknik Laboratorit	61.3
5	Merita	Hasanaj	Vlorë	Teknik Laboratorit	47.5
6	Rexhina	Hashtaj	Vlorë	Teknik Laboratorit	46.8
7	Melina	Hoxhaj	Vlorë	Teknik Laboratorit	46.4
8	Elvana	Mucaj	Vlorë	Teknik Laboratorit	45.6

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Elda	Duraj	Berat	Teknik Imazherie	67.8
2	Sara	Gega	Berat	Teknik Imazherie	59.2
3	Adela	Plaku	Berat	Teknik Imazherie	57
4	Rrape	Manxhuku	Berat	Teknik Imazherie	56.4
5	Saimir	Oeraj	Berat	Teknik Imazherie	45

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Arenc	Sakaj	Qarku Fier	Teknik Imazherie	65.9
2	Valbona	Bali	Qarku Fier	Teknik Imazherie	57.4
3	Rrape	Manxhuku	Qarku Fier	Teknik Imazherie	56.4
4	Elisabeta	Karaj	Qarku Fier	Teknik Imazherie	52.1
5	Greta	Hema	Qarku Fier	Teknik Imazherie	49.6
6	Marjo	Saliq	Qarku Fier	Teknik Imazherie	48.7
7	Anest	Zyka	Qarku Fier	Teknik Imazherie	48.5
8	Xhulia	Plaku	Qarku Fier	Teknik Imazherie	42.3

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Ornela	Keçi	Durrës	Teknik Laboratorit	68.3
2	Ana	Angjeli	Durrës	Teknik Laboratorit	68
3	Marsela	Kanaci	Durrës	Teknik Laboratorit	58
4	Florian	Ibrahimi	Durrës	Teknik Laboratorit	52.8
5	Sidorela	Maja	Durrës	Teknik Laboratorit	51.5
6	Liridona	Aslanaj	Durrës	Teknik Laboratorit	51.4
7	Enkelelda	Hoxha	Durrës	Teknik Laboratorit	46.7
8	Anxhela	Buzi	Durrës	Teknik Laboratorit	45
9	Ejlona	Reçi	Durrës	Teknik Laboratorit	43.3
10	Jetmira	Berisha	Durrës	Teknik Laboratorit	42.9

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Antonio	Bakaj	Korçë	Teknik Imazherie	59
2	Danielë	Fotiadhis	Korçë	Teknik Imazherie	53.8
3	Anisa	Mimini	Korçë	Teknik Imazherie	48.7
4	Illir	Shkëmbi	Korçë	Teknik Imazherie	46.6

Raportet e personazheve të njohura, që u krisën përgjithmonë

Dikur miq, sot armiq! Ja disa nga zënkat më të bujshme të këngëtarëve shqiptarë

"Genta Ismailin e tmerron sukcesi i Dafina Zeqirit"

Egla Xhemali

Dikur raportet e ngushta të këngëtarëve shqiptarë ishin shembulli i miqësive të singerta. Projekte të menduara për t'i nxjerrë në bashkëpunim, dalje në ambiente publike, si dhe një sërë situatash që na bënin të mendonim për një lidhje shoqërore, që do zgjaste përjetë. Mirëpo, aq të dashur dhe aq miq të ngushtë sa ishin, u kthyen në armiq dhe sot shumë prej tyre për një arsye apo një tjetër nuk i flasin më njëri-tjetrit. Më poshtë ju listojmë miqësitë e forta të "show bizz"-it shqiptar, që u kthyen në armiqësi.

GENTA ISMAILI DHE DAFINA ZEQRIT

Dy këngëtarët e dashura për publikun nuk i gëzohen suksesit të njëra-tjetrës. Armiqësinë mes tyre e nxori zbuluar menaxheri personal i Gentës në momentin që pati një konflikt mes këngëtarëve. Ai u shpreh se "Gentën e tmerron sukcesi i Dafina Zeqirit dhe e shan shumë atë". Dafina dhe Genta kanë qenë rivale të flakta gjatë viteve të fundit, me një ndarje 50 me 50 të fansave.

ROZANA RADI DHE REZARTA SHKURTA

Kjo mbetet një nga përplasjet më të komentuar të "show bizz"-it shqiptar, pasi degjeneroi në një dhunë të fuqishme fizike. Krisja mes Rozana Radit dhe Rezarta Shkurtës nisi në "show"-n "VIP Shpija" në Kosovë. Në dukje ishte një zënkë banale dhe vetë ato të dyja u përpoqën ta kalojnë me sportivitet, duke uruar njëra-tjetrën për suksesin e radhës në festivalin "Kënga Magjike". Por, pak kohë më vonë dy vajzat u zunë keq me njëra-tjetrën. Të dyja artistet pretenduan pafajësinë dhe pas një procesi të gjatë, gjykata vendosi që ta shpallte Rezarta Shkurtën jo fajtoresh ndaj akuzave të Radit, e cila asokohe ka thënë se do ta çojë çështjen në Gjykatën e Apelit. Nuk e dimë nëse gjyqi ka përfunduar, por një gjë është e sigurt, këngëtarët nuk janë më mike si më parë.

ADELINA ISMAJLI



Big Basta dhe Samanta



Genta Ismaili dhe Dafina Zeqiri



Çiljeta Xhilaga dhe Filloreta Raçi (Fifi)



Adelina Ismajli dhe Leonora Jakupi

DHE LEONORA JAKUPI

Ky është një sherr shumë i hershëm. Gjithçka nisi gati një dekadë më parë në "backstage"-t e një koncerti, ku bëheshin parapërgatitjet për regjistrimet e një spektakli për Vitin e Ri. Ende nuk dihen arsyet se përse ato janë zënë atë kohë, veç thashethemeve se rrahja e tyre më shumë ka qenë për çështje politike sesa për



Altuna Sejdiu dhe Adelina Tahiri

çështje xhelozie. Në një intervistë që i është bërë këngëtares Adelina Ismajlit, është zbuluar se nuk ka faj për zënkën me Leonora Jakupin. E ndërsa pyetjes nëse janë pajtuar, këngëtarja i është përgjigjur se nuk e sheh të arsyeshme. Pas deklaratave të Adelina, nuk ka munguar reagimi i këngëtares tjetër të njohur Leonora Jakupi, e cila ka kërkuar ballafaqim publik. "Asgjë nga ato që ka thënë nuk është e vërtetë. Nuk mund të dalë në një studio ashtu kot dhe të thotë gjëra të paqena. Pse doli të flasë për këtë çështje pas 10 vitesh?! E ftoj në një debat publik, sepse në ndryshim nga ajo, unë i kam gjërat e faktuara", - ka thënë Leonora.

ALTUNA SEJDIU DHE ADELINA TAHIRI

Dy këngëtarët nga Shkupi nuk shkojnë fare mirë me njëra-tjetrën. Shpesh kanë qarkulluar zëra se këngëtarët u bënë armike, pasi të dyja janë përfolur për një flirt me Blerim Destanin, edhe pse në fund të kësaj historie aktori nuk rezultoi në marrëdhënie me asnjërën prej të dyjave. Në kohën që kanë qarkulluar këto thashetheme, Adelina ka pohuar se në jetën e saj e ka takuar vetëm një herë Blerim Destanin. Ndërkohë Tahiri, një armiqësi të heshur të kësaj natyre e ka pasur me Genta Ismailin për futbollistin Lorik Cana.

BIG BASTA DHE SAMANTA

Ata patën një bashkëpunim mjaft të suksesshëm me titullin "Start", por që sot nuk flasin më me

njëri-tjetrin. Samanta kohë më parë ka qenë pjesë e studios së "Big Bastës" dhe bashkëpunimi mes tyre dukej se ishte në rrugë të mbarë derisa nisën problemet. Sipas reperit, Samanta refuzoi t'i paguante lekët e këngës Big Bastës. Sot nuk bëhet me dije nëse këngëtarët kanë komunikim me njëri-tjetrin.

ÇILJETA XHILAGA DHE FILLORETA RAÇI (FIFI)

Dy këngëtarët e njohura shqiptare, Çiljeta Xhilaga dhe Filloreta Raçi, dikur kanë qenë shoqe shumë të ngushta. Madje, e ftuar në një emision televiziv, Çiljeta ka treguar se për shumë kohë ajo ka qenë mikpritëseja e Fifit në Tiranë, duke e mbajtur edhe në shtëpinë e saj. Mirëpo, ka qenë Fifi, ajo e cila në një intervistë i ka kërkuar falje publikisht Çiljetës. Ajo ka deklaruar se Çiljeta Xhilaga është mërziur me të pasi ajo i ka dhënë pak pikë për këngën e saj "Hajmali" gjatë konkurimit të "Kënga Magjike". Kështu, raportet mes këngëtarëve sot janë të mira.

BIG MAMA DHE ROVENA STEFA

Big Mama u kap për flokësh me këngëtarën e muzikës popullore, Rovena Stefa. Ajo u shpreh se Stefa i kishte marrë të dashurin. Artistja ka deklaruar se e kishte strehuar në shtëpi këngëtares e muzikës popullore Rovena Stefa dhe e kishte ndihmuar që të ndërtonte një karrierë në Kosovë dhe si shpërblim, kjo e fundit "i kishte marrë të dashurin". Rovena ka heshtur gjithmonë për këtë çështje.

"Të vlerësojnë nga marka e makinës dhe togëza e rripit", Albi Nako thumbon keq femrat shqiptare

Ai është një nga koreografët më zë të momentit. Albi Nako së fundmi në rrjetet sociale ka vendosur që të shpërndajë për ndjekësit e tij disa shprehje apo situata të ndryshme, të cilat shtypi rozë i ka komentuar shpesh. Koreografi kësaj radhe vëmendjen e kishte drejtuar te femrat. Një shprehje disi thumbuese, por edhe një realitet disi i hidhur, sipas Albit. Nga teksti i shpërndarë kuptohet se femrat në ditët e sotme i kushtojnë më shumë rëndësi pamjes së jashtme dhe pasurisë materiale se sa dijes dhe kulturës së një personi. "Nëpër vendbanimet tona nuk ka libra dhe biblioteka, por në çdo lagje ka një palestër për mirëmbajtjen e trupit, sepse te ne nuk është e turpshme të jesh 'trutrashë', por trup-trashë. Vajzat tona nuk vlerësojnë djalin nëpërmjet asaj që ka në kokë e shpirt, por për nga marka e xhipit dhe nga togëza e rripit", - janë fjalët e shkruara në postimin e Albit.



"S'ti mora ty lekët"! Sabri Fejzullahu reagon pas fjalëve të Flor Mumajesit

Fundjavën që lamë pas bëri bujë "zënka" mes Sabri Fejzullahut dhe Flori Mumajesit. Këngëtari i njohur kosovar gjatë një interviste tha për Florin se është e pamundur t'i marrë aq shumë klikime për një ditë, por nuk mund të mungonte reagimi i kantautorit Mumajesi. "Ncncncnc? Pse xhaxha Sabri kapesh me mua? Edhe po t'i kem blerë, s'ti kam marrë ty paratë! Pse po merrizitesh kaq shumë? I kam lënë të tjerët të ndihem mirë se nuk kam qenë, nuk jam e as kam me qenë ndonjëherë unë shembulli për blerje klikimesh! Kurrkujt s'i futem në xhep e në jetën e vet. Kur i bëjnë vetë shumë klikime, nuk ndihen, veç fërkojnë gjoksin sikur janë artistë të mëdhenj. Kur nuk i bën vetë e i bëjnë të tjerët, merrren me llafe. Nejse, e vërtetë klikimet edhe mund të blihen xhaxha Sabri, po si t'ia bëjmë kur ta blejnë karrierën?", shkroi Flori, ndërsa sot Sabri Fejzullahu ka reaguuar më në fund. Ai ka shpërndarë postimin e Florit dhe i ka bashkangjitur disa emoji zemra si për të na treguar që mes tyre nuk ka asgjë për t'u shqetësuar.




U tha se u "arratis" me Noizyn, Tayna zbulon se me kë ishte në Tailandë

Para pak ditësh Tayna dhe Noizy kaluan disa momente pushimi dhe krejt rastësisht zgjodhën destinacionin tropikal, Tajlandën, për të kaluar pak kohë larg zhurmave të qytetit dhe stresseve profesionale. Pak foto të publikuara nga dy reperët kanë mjaftuar për të nisur fjalët se po pushojnë bashkë apo po ndodh diçka mes tyre, por ishte Tayna, ajo që hoqi çdo dyshim pasi publikoi një foto me prindërit, duke zbuluar kështu shoqëruesit e saj në këtë udhëtim. Së fundmi, ajo është bërë pjesë e opsionit "pyetje-përgjigje" në "Instastory" dhe njëri prej ndjekësve e pyet reperen nëse është penduar që ka marrë prindërit me vete dhe jo shoqërinë apo ndonjë shok. "Nuk ka më shok se babi dhe më shok se mami në jetë", - ia kthen Tayna ndjekësit, përgjigje që me siguri ka prekur zemrat e të gjithëve.



E pyesin nëse është e lidhur, ja si u përgjigjet Klaudia Pepa ndjekësve të saj

Balerina e njohur shqiptare, Klaudia Pepa, prej kohësh po vazhdon karrierën e saj në Itali, ku dhe është mjaft e njohur. Klaudia është shumë aktive në rrjetet sociale, ku herë pas here publikon video me koreografitë e krijuara prej saj, të cilat janë pëlqyer shumë nga publiku. Ditën e djeshme balerina simpatike ka bërë një video 'live' në "Instagram", ku është shfaqur me të ëmën, motrën e saj dhe gjyshen e sigurisht nuk mund të mungonin pyetjet nga më të ndryshmet e këtu nuk bën përjashtim as ish-partneri i saj Albi Nako. Një fansë e pyeti "Ku e ke Albin?" dhe Klaudia u përgjigj: "Me të thënë të drejtën nuk e di ku është, por e përsëhëdësim Albin" dhe i thotë motrës "Apo jo? Po, po se jemi të mira". Më pas u pyet nga një fans nëse është akoma 'single' dhe Klaudia tha: "Po, jam akoma 'single'". Pra, Klaudia s'e ka gjetur ende princin e kaltër.



Scott fajëson të dyja palët për mosbisedime, reagon kreu i Serbisë: Përbahu o burrë!

Vuçiç: S'ka marrëveshje të bazuar në modelin e të dyja Gjermanive

Presidenti serb mohon planin për ndryshimin e kufijve

Lidhur me dialogun me Serbinë, për Presidentin serb, Aleksandar Vuçiç, mundësitë për marrëveshje janë shumë më të vogla sesa kanë qenë. Ai bëri me dije se Prishtina nuk do ta vazhdojë dialogun derisa të përfundojë mandati i administratës aktuale evropiane, zgjedhjet për të cilën janë parashikuar të mbahen më 17 maj. Presidenti serb mohoi ekzistencën e një plani prej 17 pikash për ndryshimin e kufijve, ndërsa theksoi se askush nuk e dëshiron një marrëveshje bazuar në modelin e dy Gjermanive. Bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë ndërprerë për shkak të vendosjes së tarifës ndaj mallrave serbe nga ana e qeverisë së Kosovës. Zgjedhjet e reja për institucionet evropiane janë paraparë të mbahen në fund të muajit maj. Vuçiç përsëriti se Prishtina nuk do ta shfuqizojë së shpejti tarifën ndaj mallrave serbe dhe të Bosnjës, përderisa përgjegjëse për këtë situatë e bëri edhe BE-në, që sipas tij, ka mekanizma që do t'i kushtojnë shumë shtrenjtë Prishtinës por që nuk po i zbaton. "Pa një marrëveshje me Beogradin, Prishtina nuk mund të bëjë asnjëherë asgjë", tha presidenti serb. Ai mohoi se ekziston një plan prej 17 pikësh për ndryshimin e kufijve me Kosovën. Presidenti



ALEKSANDAR VUČIĆ

"Pa një marrëveshje me Beogradin, Prishtina nuk mund të bëjë asnjëherë asgjë. Shqiptarët më nuk duan të dëgjojnë për një marrëveshje bazuar në modelin e dy Gjermanive. Ata dyshojnë se Rusia do ta pranonte këtë në OKB, nëse edhe ne e pranojmë atë", - tha Vuçiç.

serb tha, gjithashtu, se askush nuk e dëshiron një marrëveshje bazuar në modelin e dy Gjermanive. "Shqiptarët më nuk duan të dëgjojnë për këtë, ata dyshojnë se Rusia do ta pranonte këtë në OKB, nëse edhe ne e pranojmë atë", tha Vuçiç. Brukseli dhe Uashingtoni po bëjnë thirrje që palët të ndalin veprimet që dëmtojnë procesin negociator dhe të kthehen në tryezën e bisedimeve. Nga ana tjetër

presidenti serb është befasuar me deklaratat e ambasadorit amerikan në Beograd Kyle Scott. "Përbahu o burrë", i ka thënë Vuçiç diplomatit amerikan. Scott ka fajësuar të dy palët për ndaljen e dialogut me Kosovës e Serbisë. Vuçiç e pyet ambasadorin se "çfarë faji ka Serbia". "Jam i befasuar me deklaratën e Scottit. Përbahu o burrë. Thotë se jemi bashkëfajtor. Më thuaj për çfarë jemi ne fajtorë", ka

pyetur Vuçiç diplomatit amerikan gjatë një interviste në TV Happy të Serbisë. Ai ka thënë se Serbia nuk ka marrë masa kundër Prishtinës, pas vënies së takës prej 100 për qind nga qeveria e Kosovës për produktet serbe. Gazetari e pyeti rreth opsioneve që janë dhënë në Serbi për vendosjen e bllokadave për Kosovën si kundërmasa. Vuçiç tha se "a mendojnë ata të mençur se çfarë ndodh me serbët në Kos-

ovë. Apo mendojnë se ne mund ta kalojmë një ligë që thotë: lejohet hyrja për serbët ndërsa jo për shqiptarët", si në Gjermaninë e Hitlerit". Më tej, Vuçiç ka thënë se ka marrë kritikë nga zyrtarët e lartë amerikanë si Wess Mitchell e Matthew Palmer, se ai ka qenë i padrejtë në kontekstin e dialogut me Prishtinën, sepse për shkak të qëndrimit të Serbisë disa shtete kanë tërhequr njohtjen ndaj Kosovës.

SHKURT

Maqedonia e Veriut, rritet numri i të prekurve nga fruthi

Në Strugë vazhdon të rritet numri i të prekurve nga fruthi. Të paktën dy raste të tjera janë shënuar dje, ndërsa numri i përgjithshëm i tyre ka mbërritur në 26. Nga spitali i Strugës thonë se dy ditët e fundit pas shpalljes së epidemisë së fruthit është rritur numri i prindërve që i sjellin fëmijët e tyre për vaksinim. "Në Strugë ditët e fundit u infektuan, gjithashtu, edhe shtatë punonjës. Ndërsa, nga Qendra e Shëndetit Publik në Ohër, sigurojnë se ka vakcina të mjaftueshme", tha Mentor Ibraimi, doktor imjeksisë shkollora. Në çdo moment, Qendra e Shëndetit Publik është në dispozicion me një numër të mjaftueshëm të vaksinave kundër fruthit, për të gjithë ata që kanë nevojë nga 12 muaj deri në 45 vjeç. "Duke pasur parasysh që numri tashmë ka tejkaluar 24 persona me fruth, presim që ky numër të rritet në 10 deri 15 ditët e ardhshme", theksoi Sasho Toçkov, drejtor i Qendrës për Shëndetësi Publike. Shkollat dhe kopshtet në Strugë u udhëzuan, që të rrisin nivelin e higjienës, të respektohen rekomandimet për dezinfektim dhe ajrosje të hapësirave, por edhe të mos pranohen fëmijë të pavaksinuar. Autoritetet shëndetësore presin që epidemia të vazhdojë të përhapet.

Ish-komandanti i UÇK-ambasadorit të SHBA:

Jam kriminel lufte

Sylejman Selimi, ish-komandanti i UÇK-së, për herë të parë ka folur për deklaratat e ambasadorit amerikan në Kosovë, që ky i fundit i kishte bërë në lidhje me emërimin e tij si këshilltar i Haradinajt. Sylejman Selimi, në emisionin "Debat Plus" i ka "dhënë" të drejtë ambasadorit Kosnett, pasi ai thotë se është e vërtetë se ai me dokumentacion është kriminel lufte. "Është parim, përderisa jam i dënuar është normale që mundet me thënë që jam kriminel lufte. Me dokumentacion unë jam kriminel lufte", ka thënë Sylejman Selimi. Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett kishte reaguar pasi Sylejman Selimi ishte emëruar si këshilltar i kryeministrit Ramush Haradinaj. "Të dënuarit për krime lufte në Kosovë nuk kanë vend në qeverinë e Kosovës. Udhëheqësit e të gjitha institucioneve duhet të ndalojnë mbështetjen ndaj individëve të tillë. Një mbështetje e tillë vë në dyshim angazhimin e Kosovës, në sundimin e ligjit. I kënaqur për të parë reagimet e komuniteteve për këtë temë", kishte shkruar ambasadori Kosnett, në një reagim gjatë muajit të kaluar.

Kryeministri maqedonas: Do bllokohen negociatat me BE

Zaev e Mickoski në debat televiziv, të ndarë për emrin dhe Prokurorinë Speciale

Dallimet lidhur me faktin e Prokurorisë së Posaçme Publike që po merret me zbardhjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit kanë qenë molla shërr. Mazhoranca propozon që ky institucion të bëhet pjesë e Prokurorisë Publike, por me financa të caktuara, kurse opozita mbron qëndrimin se ky dikaster nuk duhet të ketë buxhet të vetin. "Çështja është nëse do të bllokohet sërish vendi ynë dhe do të humbasë fillimin e negociatave me Bashkimin Evropian për llogari të mbrojtjes së kriminelëve", tha kryeministri Zoran Zaev. "Ne këtë problem e shikojmë në mënyrë thelbore. Nuk e shikojmë si numër. Ajo që bëni ju është sipas parimit 'merre ose lëre'. Ky parim është i pandershëm ndaj qytetarëve që dhanë votën e tyre për opozitën si dhe për ata që dhanë votën për pozitën", u shpreh kryetari i VMRO-DPMNE.



ZORAN ZAEV

"Çështja është nëse do të bllokohet sërish vendi ynë dhe do të humbasë fillimin e negociatave me Bashkimin Evropian për llogari të mbrojtjes së kriminelëve", tha kryeministri Zoran Zaev.

HRISTIJAN MICKOSKI

"Ne këtë problem e shikojmë në mënyrë thelbore. Nuk e shikojmë si numër. Ajo që bëni ju është sipas parimit 'merre ose lëre'. Ky parim është i pandershëm ndaj qytetarëve që dhanë votën e tyre për opozitën si dhe për ata që dhanë votën për pozitën", u shpreh kryetari i VMRO-DPMNE.

si dhe për ata që dhanë votën për pozitën". U shpreh kryetari i VMRO-DPMNE, Hristijan Mickoski. Një tjetër çështje ishte nëse opozita e sotme, VMRO-DPMNE, nesër vjen në pushtet, a ka për ta njohur Marrëveshjen e Prespës? "Do të punojmë që të korrigjohim gjithë pasojën që është rezultati i

kësaj marrëveshjeje dhe këtë kurrë, kurrë nuk do të rreshtim ta bëjmë", tha Mickoski. "Fituam gjithçka që deshën paraardhësit tanë, baballarët e gjyshërit! Dhe kjo është arritja. Këta nuk guxojnë të pranojnë, të bëjnë hapin përpara e të ndërtojnë qëndrim, për shkak se nuk thotë nëse ka për ta anuluar ose jo Marrëveshjen", iu shpreh Zaev. Sipas analistëve, megjithëse është quajtur si "duel i dhjetëvjeçarit", përballja dyorësh e kryeministrit Zaev dhe shefit të opozitës maqedonase Mickoski, veç vullnetit të ballafaqimit, nuk solli ndonjë cilësi e as sinjal për uljen e tensioneve dhe të retorikës tashmë të njohur, të cilën shumëkush e vë në funksion të fushatës parazgjedhore për zgjedhjet presidenciale të 21 prillit.

Rritet numri i të sëmurëve, bie shkalla e vaksinimit

Alarm për gjendje të jashtëzakonshme, një qark në Nju Jork infektohet nga fruthi

Një qark në Nju Jork ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme pas raportimeve se është duke u rritur numri i personave të prekur me sëmundjen e fruthit. Qarku Rokland, në veri të qytetit të Nju Jorkut, u ka ndaluar fëmijëve të pavaksinuar që të qarkullojnë në hapësira publike. Shkelësit e këtij urdhri do të ndëshkohen me 500 dollarë gjobë dhe rreth gjashtë muaj burgim. Ky njoftim ka ardhur pas raportimeve për përhapje të kësaj sëmundjeje në Uash-



KREU I SHËNDETIT PUBLIK

"Ne nuk do të qëndrojmë ulur derisa fëmijët e komunitetit tonë janë në rrezik. Kjo është krizë e shëndetit publik dhe është koha të veprojmë", ka thënë shefi ekzekutiv i qarkut Rokland, Ed Day.

ington, Kaliforni, Teksa dhe Illinois. Shkalla e vaksinimit ka rënë shumë në Shtetet

e Bashkuara, pasi prindërit përmendin një varg arsyesh filozofike apo fetare, si dhe

dilemat se këto lloje të vaksinave mund të shkaktojnë autizëm te fëmijët. "Ne nuk do

të qëndrojmë ulur derisa fëmijët e komunitetit tonë janë në rrezik", ka thënë shefi ekzekutiv i qarkut Rokland, Ed Day. "Kjo është krizë e shëndetit publik dhe është koha të veprojmë", ka shtuar ai. Italia u kushtëzoi fëmijëve shkollimin me vaksinim. Sa i përket Evropës, vetëm në vitin 2018 janë raportuar 82,500 raste të prekur me këtë sëmundje, duke shënuar kështu shifrën më të lartë në dekadën e fundit. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka thënë se lëvizja kundër-vaksinimit do të jetë një nga rreziqet kryesore për shëndetin e njeriut më 2019.

Tusk: Do presim nëse Britania rishqyrton strategjinë për dalje nga BE

Shtyrje pa afat për Brexit, May në dilemë për dorëheqjen

Vendimi në 12 prill, gjithçka në dorë të Dhomës së Poshtme



DONALD TUSK

"Duhet të jemi të hapur për një shtyrje të gjatë, nëse Britania e Madhe e rishqyrton strategjinë e saj të Brexitit. Ka një shumicë në rritje njerëzish në Britaninë e Madhe, që duan të qëndrojnë në BE, e argumentoi Tusk propozimin e tij. Deputetët e BE nuk mund të "tradhetojnë" zgjedhësit proevropianë britanikë. Me këtë Tusk iu drejtua atyre parlamentarëve, të cilët kanë frikë se me një pjesëmarrje të Britanisë së Madhe në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, në parlament do të hyjnë sërish shumë kundërshtarë të BE. Një mënyrë e tillë të menduarit është e papraueshme, tha Tusk. Ai tërhoqi vëmendjen për rreth gjashtë milionë britanikët, të cilët nënkrahuan së fundi një petition në internet për qëndrimin e Britanisë së Madhe në BE. Më tej ai foli edhe për rreth një milion vetët, që dolën në fundjavë në rrugët e Londrës për të kërkuar që Britania e Madhe të qëndrojë në BE, shkruan 'DW'. BE i ofroi së fundi Britanisë së Madhe një shtyrje të daljes nga BE deri në 22 maj, nëse Dhoma e Poshtme voton këtë javë në mbështetje të marrëveshjes së negociuar midis kryeministres Theresa May dhe BE. Nga ana tjetër, në 12 prill, qeveria britanike duhet të paraqesë lutje për një shtyrje më të gjatë, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në zgjedhjet evropiane ose edhe të tërheqjes së kërkës për të dalë nga BE. Po të mos ndodhë kjo, Britania e Madhe do të dalë me pasojë që priten të rëndë ekonomike, për të dyja palët, në mënyrë të parregullt nga BE. Këtë Dhoma e Poshtme në Londër kërkon ta pengojë me çdo

kusht. Deputetët kanë marrë në dorë kontrollin për procesin e Brexitit dhe do të votojnë më vonë për alternativa ndaj Marrëveshjes së Brexitit. Në Londër u tha se po shqyrtohet edhe opsioni, që Dhoma e Poshtme të miratojë marrëveshjen me BE dhe kryeministria May të ofrojë nga ana e saj dorëheqjen. Më parë qe parashikuar që Brexitit të ndodhte këtë të premte. Ndërkaq dorëheqja e kryeministres britanike shihet si mundësia ideale për të shpëtuar marrëveshjen që ajo arriti me Brukselin. Akordi i negociuar nga May mbetet tashmë e vetmja mundësi që Britania të shkëputet me një marrëveshje nga Bashkimi Evropian. Mundësia e dorëheqjes së May t duket se ka përçarë edhe deputetët rebelë brenda konservatorëve. 20 prej tyre me në krye ish-Ministrin e Jashtëm, Boris Johnson thonë se janë gati të mbështesin marrëveshjen, nëse May nuk do të jetë në krye të qeverisë kur të

OFICERJA NGATËRRON ARMËN, PLAGOS AFRO-AMERIKANIN

Një veprim i nxituar i një policjeje amerikane i ka kushtuar asaj përjashtimin nga radhët e policisë. Brindley Blood plagosi me armë një afro-amerikan, i cili po përleshje me kolegun e saj të patrullës, pas një debati për rripin e sigurimit. Ajo duhej të përdorte armën paralizuese, por u ngatërrua dhe qëlloi me pistoletë me plumba. Ngjarja që daton në maj të 2018-s u filmua nga kamera e bordit e automjetit të policisë në periferi të Kansasit. I plagosur mbeti 35-vjeçari Akira Lewis, i cili u konfrontua fizikisht me policin tjetër të patrullës.



FOTOLAJM

nisë faza e dytë pas shkëputjes. Ndërsa pjesa tjetër thonë se do ta votojnë, nëse marrëveshja merr edhe mbështetjen e unionistëve irlandezë që ende nuk janë bindur. Nga dita e martë kanë nisur diskutimet në parlamentin britanik për të gjitha alternativat e sh-

këputjes. Nëse marrëveshja nuk miratohet deri të premtën e 29 marsit, deputetët duhet të vendosin për pranimin e propozimit të Brukselit për shtyrjen me një muaj, të afatit të shkëputjes. Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk tha se Britanisë duhet t'i jepet një afat

i gjatë për të zgjidhur çështjen Brexit. Para nisjes së seancës së Parlamentit Evropian, Tusk shkroi në Twitter se Brukseli nuk duhet të tradhetojë 6 milionë britanikët që mbështesin anulimin e Brexit-it dhe se shtyrja e pakufizuar mund t'i ndihmojë ata të arrijnë qëllimin.

SHKURT

Bie helikopteri i MB në Kazakistan, 13 persona në bord

Helikopteri Mi-8 i Ministrisë së Mbrojtjes të Kazakistanit është rrëzuar dhe djegur plotësisht në rajonin e Kyzylorda. Rrethanat e rrëzimit po sqarohen, ka thënë zëdhënësi i Komisionit të Emergjencave të Kazakistanit, Nursultan Nurakhmetov. Ministria e Mbrojtjes e Kazakistanit në një deklaratë ka bërë të ditur se ishin 13 persona në bord. Nuk dihet ende për fatin e këtyre personave, por gjasat për shpëtim thuhet se janë të vogla.

Izraeli përgatit sulme të reja në Gaza

Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu, pas kthimit nga Uashingtoni, ka planifikuar konsultime ushtarake emergjente pas sulmeve me raketa në Gaza. Mediat izraelite, duke iu referuar një zyrtari izraelit të paidentifikuar, thonë se nuk është arritur një marrëveshje për ndalimin e zjarrit me Hamasin dhe se Netanyahu e udhëzoi ushtrinë që të vazhdojë të sulmojë objektivat. "Nuk ka marrëveshje për armëpushim", tha zyrtari, duke shtuar se Izraeli është gati për sulme edhe më të mëdha. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu tha të premtën se është i gatshëm të urdhërojë veprim të mëtejshëm në Gaza, e cila kontrollonet nga Hamas, pas sulmeve ajrore izraelite si kundërpërgjigje të një zjarri raketash nga territori Palestinez.

Papa bezdiset nga puthja e unazës

Ka tërhequr mjaft vëmendje momenti kur Papa Françesku u largoi dorën besimtarëve që përulen për t'ia puthur. Pamjet janë filmuar në Bazilikën e Shtëpisë së Shenjtë në Loreto, atje ku pas meshës Papa nisi të përshëndetë me mbi 100 priftërinj e besimtarë. Në mënyrë të përsëritur ai refuzon t'u shtrijë atyre dorën, madje duke i vënë në siklet. Tradita e kishës katolike është që të gjithë personat që takohen me Papën, i puthin atij unazën që e mban në gishtin e tretë të dorës së djathtë dhe që konsiderohet të jetë simboli më i fuqishëm i Pontifikatit. Por meslimin e puthjes së unazës së tij, Papa Françesku e ka të përsëritur. Gjesti është interpretuar si përpjekje e tij për t'i dhënë fund për të parën herë në histori kësaj tradite.

MESAZHET

DITA BOTËRORE

Mesazhet me ironi: Teatri shemb regjime

Në Ditën Botërore të Teatrit kanë qenë të shumta mesazhet e dhëna nga aktorë e njerëz të skenës. Por shpesh në fjalët e tyre gjen edhe ironi, ndërsa Dita botërore e gjen Teatrin Kombëtar të strehuar në një godinë dhe godinën e tij duke rënë.

Po botojmë më poshtë mesazhin e një prej emrave më në zë botërorë të këtij arti dhe dy aktorëve shqiptarë.



*Carlos CELDRÁN, Cuba

"Ka që duan teatrin, ka që duan veten e tyre në teatër"



EMA ANDREA

Teatri nuk është "lojë shpiash", ku fqinjët mbledhen me pi kafe e me "vra" kohën, nuk është mjet deliri e fame "te lagja jonë", nuk është garë "kush ja hipën më shumë"! Teatri nuk kërkon pushtet, sepse ka lind prej vetes, e ka pushtetin e ndërgjegjes, lind me ne e vazhdon të jetojë edhe kur ne ikim! Shkruhet në rërë çdo nate, dallgët e era që i shkojnë përsipër nuk e fshijnë, por e kthejnë te i Zot-Njeriu që mbet pa formë kur i mungon Arti përgjatë rrugëtimit të ngushtë drejt fundit! Duhet me ditë me e dasht Teatrin, çdo ditë, me kurajë e përkushtim! Teatri frikëson ashtu si e vërteta! Ndaj, kush e "përdor" prej mundësisë apo pamundësisë me e dasht, duhet me pas kujdes se çfarë shkruan në rërë! Era e dallgët "kthehen në shtëpi" gjithmonë!

Para se t'i hapja sytë drejt teatrit, mësuesit e mi tashmë ishin atje. Ata kishin ndër-tuar shtëpitë e tyre dhe qasjet e tyre poetike mbi mbetjet e jetëve të tyre. Shumica prej tyre janë të panjohur, apo pothuajse nuk kujtohen: kanë punuar në heshtje, në përlësinë e dhomave të provave dhe në teatrot e mbushura përplot spektatorë dhe, ngadalë, pas vitesh pune dhe arritjeje të jashtëzakonshme, ata gradualisht shkuan nga këto vende dhe u zhdukën. Kur unë kuptova se fati im do të ishte të ndiqja hapat e tyre, kuptova se kisha trashëguar atë traditë të hidhur, unike të të jetuarit në të tashmen pa ndonjë pritje tjetër përveç se të arrish transparencën e castit të papërsëritshëm: takimit me një tjetër në errësirën e një teatri, pa mbrojtje të mëtejme sesa vërtetësia e një gjesti, një fjale që shpërfaqet.

Atdheu im teatror qëndron në ato momente të takimit me spektatorët që vijnë në teatrot tona natë pas nate, nga këndet më të ndryshme të qytetit tim, të na shogërojnë dhe të ndajnë disa orë, ca minuta. Jeta ime është ndër-tuar nga ato momente unike kur unë pushoj së qeni vetja, të vuaj për veten, dhe rilindem dhe e kuptoj domethënien e profesionit teatror: të jetosh çaste të një të vërtete të

pastër kalimtare, ku e dimë se ajo që themi dhe bëjmë, atje nën dritat e skenës, është e vërtetë dhe reflektuar pjesët më të thella, më personale të vetes sonë. Vendi im teatror, imi dhe ai i aktorëve të mi, është një vend i endur nga momente të tilla, ku lëmë pas maskat, retorikën, frikën e të qenit kush jemi dhe rrokemi duarsh në errësirë.

Traditë teatrorë është horizontale. Askush nuk mund të pohojë se teatri ekziston në ndonjë qendër të botës, në ndonjë qytet apo ndërtesë të privilegjuar. Teatri, siç e kam marrë, përhapet përmes një gjeografie të padukshme që bashkon jetët e atyre që e performojnë dhe mjeshtrësitë teatrorë në një gjest të vetëm unifikues. Të gjithë mjeshtrit e teatrit vdesin me momentet e tyre prej një qartësie e bukurie të papërsëritshme; ata të gjithë shuhën në po të njëjtën mënyrë, pa ndonjë tjetër epësi që t'i ruajë ata dhe t'i bëjë të shquar. Mësuesit teatrorë e dinë këtë, asnjë pranim nuk është i vlefshëm kur përballim me atë siguri që është burimi i punës sonë: krijimi i casteve të vërtetësisë, të dykuptimësisë, të fuqisë, të lirisë në mes të një pasigurie të madhe. Asgjë nuk mbijeton përveç të dhënave apo shënimeve të veprave në video dhe fotografi që do të mund ta kapte qoftë një ide të zbehtë të asaj

që bënë. Sidoqoftë, ajo që do të mungojë gjithmonë nga këto të shënime është përgjigja e heshtur e publikut, i cili kupton në një çast se ajo që ndodh nuk mund të përkethehet e as të gjendet jashtë, se e vërteta që shpërndahet aty është një përvojë jetësore, për pak sekonda, më e tejdukshme sesa vetë jeta.

Kur e kuptova se teatri ishte një vend më vete, një territor i madh i cili mbulon gjithë botën, një vendosmëri u ngrit brenda meje, e cila ishte, gjithashtu, realizimi i një lirie: nuk të duhet të shkosh larg, apo të lëvizësh nga ku je, nuk duhet të vraposh e as të ecësh vetë. Publiku është kudo që ti të jesh. I ke kolegët që të duhen përkrah teje. Aty jashtë shtëpisë tënde, ke realitetin e përditshëm të errët e të padepërtueshëm. Pastaj ti punon nga ajo palëvizshmëri e dukshme për të dizajnuar rrugëtimitin më të madh nga të gjithë, ta përsërisësh Odisenë, udhëtimin e argonautëve: je një udhëtar i palëvizshëm, i cili nuk ndalet së shpejtuari dendësinë dhe ngurtësinë e botës së tij reale. Rrugëtimi yt është drejt castit, momentit, drejt takimit të papërsëritshëm me shokët e tu. Udhëtimi yt është drejt tyre, drejt zemrës së tyre, drejt subjektivitetit të tyre. Ju udhëtoni me ta, në emocionet e tyre, në memoriet e

tyre të cilat ju i ngjallni dhe mobilizoni. Udhëtimi juaj është marramendës, dhe askush nuk mund ta matë apo ta heshtë atë. Asnjëri nuk mund ta njohë atë në masën e duhur, është një udhëtim përmes imagjinatës së njerëzve tu, një farë që mbillet në tokën më të largët: ndërgjegjen qytetare, etike dhe humane të spektatorëve tu. Për shkak të kësaj, unë nuk lëviz, qëndroj në shtëpi, mes më të afërmeve të mi, në qetësinë e dukshme, duke punuar ditë e natë, sepse e kam sekretin e shpejtësisë.

*Autori është president i Institutit ndërkombëtar të Teatrove (Përktheu nga anglishtja Agon Myftari)



NERITAN LIÇAJ

Kush nuk ka këllqe me dashë e luftu, luan me fjalë, por harron që teatri është fjala jo loja me fjalën! Loja me fjalën është teatër i keq! Ka që duan teatrin, ka që duan veten e tyre në teatër, ka që teatrin e urrejnin sepse nuk ishin askurrë aty me zemër, por me llogari! Teatri është vizion e brendshme, pra dashuri e madhe, por jo pasthirmë parazitare kur nuk e çon dot veprimin e batutës deri në fund! Fjala e vërtetë shëron për kë do të shërohet dhe vret për kë nuk e do. Teatri njësoj si fjala, sepse teatri është fjale, mendim, thirrje, forcë, dashuri. Shemb regjime të forta që bëjnë shumëkënd të strukturose dhe të strukturose diku si pa u ndier nga frika ose interes i vogël, po tejet i vogël!

TEATRI ka lindur nga njeriu dhe bëhet nga njeriu, jo nga kandidati për njeri! GEZUAR FESTEN E TEATRI!

DEBATI

Drejtori: Teatri i Kukullave nuk do shembet, ka vlera historike

Fatmira Nikolli

Nuk bëhet fjalë për shembje në deklaratën e kryeministrit". Kështu u shpreh dje Erion Isai, drejtor i Qendrës së Kulturës për Fëmijë dhe i Teatrit të Kukullave. Pas fjalimit të kryeministrit Edi Rama të shtunën e kaluar, ku tha se "Teatri i Kukullave është një karakteristike që na turpëron përpara fëmijëve tanë", ka qenë i menjëhershëm reagimi skenës kulturore që dalin kundër ideve të Ramës për shkatërrim të institucioneve kombëtare.

Dje Isai tha se "kryeministri në deklaratën e tij, ka thënë që nevojitet dhe do të kemi një teatër të ri kukullash, aty ku sot ndodhet Garda e Republikës. Unë deklaratën e mësova atë ditë nga fjalimi gjatë kohës që isha prezent në takim. Godina si teatër kukullash këtu ku jemi nuk është e vlefshme". Drejtori shtoi se godina ka sigurisht një vlerë historike. "Unë besoj se godina do ta vazhdojë rrugëtimin e vet historik, sepse është parlamenti i parë shqiptar dhe në opinionin tim personal godina nuk duhet të shembet. Jam i bindur që nuk bëhet fjalë për shembje, por bëhet fjalë për ndërrim destinacioni. Pra, teatri i kukullave të ketë një godinë të veten dinjitoze, ashtu siç fëmijët tanë e meritojnë", theksoi ai. Sipas Isait, duke investuar në mentalitet dhe në teatër, duke investuar në teatrin e kukullave dhe Qendrën Kulturës për Fëmijë po hidhen bazat e para të kulturës tek fëmijët. "Ne nuk po investojmë në një shfaqje, por po investojmë në një mendësi kulturore, për fëmijët dhe për një brez të ri. Po përgatisim sot një brez të ri, që do të jetë publik i Teatrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, Muzeut Historik Kombëtar, Galerisë Kombëtare të Arteve dhe po mundohemi të sjellim një brez me një gusto të mirë të kulturës. Jam i bindur që do të kemi një Shqipëri me bijë dhe bijë të reja të edukuara. Ndaj kjo është arsyeja pse ne kemi nevojë për teatër kukullash dhe pse Tirana ka nevojë për një godinë historike si Parlamenti i parë shqiptar", vërejtjti Isai.

I pyetur se çfarë do ndodhe me godinën kur teatri do jetë zhvendosur, ai tha se nuk i takon atij të flasë për këtë. "Nuk më takon mua të them se çfarë do shërbejë kjo godinë kur të ketë ndërrim destinacioni. I takon kryeministrit. Ai tha se çfarë do ndodhë me Teatrin e Kukullave, por se çfarë do ndodhë me godinën i takon Ministrisë së Kulturës dhe kryeministrit ta vendosë. Me logjikë i bie të jetë një muze për



Erion Isai

parlamentin po si do jetë është përtej kompetencave të mia. Unë jam drejtori i Teatrit të Kukullave dhe i qendrës së Kulturës për Fëmijë".

Ai u shpreh se nuk ka pasur dijeni më herët për deklaratën e Ramës, por se gjendja e teatrit nuk është optimale. "Unë që ditën që kam qenë në këtë detyrë, kemi diskutuar me ministret se çfarë mund të bëjmë për teatrin. Që duhet të jetë dinjitoz e dimë të gjithë. Deklarata e kryeministrit është pjesë e këtij shqetësimi. Që të kemi godinë dinjitoze. Ne ndërko-

Erion Isai: Kryeministri foli për zhvendosje, duhet një godinë dinjitoze për fëmijët

hë vazhdojmë punën siç kemi bërë. Nuk ka asnjë vendim për zhvendosje, as për mbyllje, i presim prindërit dhe fëmijët këtu. Godina këtu është e mbrojtur nga IMK, ndaj çdo vendim do shihet. Është rrugë e gjatë përpara", u shpreh Isai.

ÇFARË THA KRYEMINISTRI

Të shtunën e kaluar para mbështetësve në sheshin "Nënë Tereza",

kryeministri tha: "Sheshi Skënderbej sot është një kryevepdosje, as për mbyllje, e konfirmuar ndërkombëtarisht, e cila i bën Shqipërisë shërbime të mira duke i dhënë Shqipërisë çmime, komplimente dhe foto të pafundme nga vizitorët. Por Muzeu Historik është ende një fantazmë e të shkuarës mu në mes të sheshit. Opera është në kантиer dhe fatmirësisht këtë vit do të rihapë dyert dhe do të tërheqë shumë më tepër vizitorë në qënien e saj tërësisht të rilindur. Por në krah të saj

Biblioteka Kombëtare është i madhi i munguar në transformimin tonë të derikëtushëm.

Teatri i Kukullave është një karakteristike që na turpëron përpara fëmijëve tanë. Uroj dhe besoj që deri në fund të këtij mandati qeverisës ne do t'i hapim themelet e Bibliotekës së re Kombëtare dhe të teatrit të ri të fëmijëve, këtu pranë te Garda, ndërsa në mandatin e ri të Erionit do t'i hapim edhe dyert e këtyre dy institucioneve. Nuk harroj Teatrin e ri Kombëtar të cilin do ta ndërtojmë se s'bën dhe për turpin e të gjithë atyre që e kanë balto-sur pa lindur projektin tonë, le ta bëjmë teatrin e ri kombëtar një kryevepër të konfirmuar ndërkombëtarisht ashtu si 'Qemal Stafën' e vjetër, Arenën e Re Kombëtare", deklaroi Rama

FESTIVALI

Deklaratat e djeshme Erion Isai i bëri pas konferencës për mediat ku foli për sezonin artistik në teatër. Një festival ndërkombëtar me shfaqje kukullash do të mbahet nga teatri me 12 trupa nga e gjithë bota. Festivali mbahet nga data 3 deri në datë 9 maj 2019. Gjatë paraditeve në ambientet e Teatrit të Kukullave, edhe në pasditë në sheshin "Skënderbej" fëmijët do të kenë mundësi, që të shijojnë magjinë e kukullave. "Kemi si qëllim shkëmbimin kulturor, për të marrë përvojat e botës, se si një teatër kukullash bëhet edhe zhvillohet, por edhe për t'u prezantuar atyre një Shqipëri të bukur. Më pas do të rikthehemi sërish me Festivalin për Fëmijë, ku çdo këngë që do të paraqitet do të ketë edhe video-klipin e saj. Në 1 qershor do të jetë nata finale", shprehet Erion Isai, drejtori i Teatrit të Kukullave.

Sipas aktore Shëgushe Bebeti repertori i shfaqjeve do të jetë i larmishëm, duke përfshirë jo vetëm fëmijët, por edhe të rriturit.

"Shfaqjet e repertorit janë të ndryshme, ka për fëmijë, familjare, për më të rritur, në teknikën e kukullave edhe në teknika të ndryshme, të cilat na ndihmojnë shumë për të fituar jo vetëm eksperiencë, sepse dihet që ne akoma nuk kemi një shkollë të mirëfilltë për Teatrin e Kukullave, por edhe për të mësuar më shumë", thotë aktoria Shëgushe Bebeti.

Shqipëria do të prezantohet me tri pjesë teatrore në këtë festival. "Nuk e kemi vendosur akoma. Por Tirana do të ketë pjesëmarrje të veçantë, sepse do të ketë tre shfaqje, një në fillim, një në zhvillim, edhe një më pas", përfundon Erion Isai, drejtor i Teatrit të Kukullave.

Buxheti artistik për Teatrin e Kukullave është vetëm 3.5 mln lekë. 75 për qind e buxhetit për shfaqjet është siguruar nga mbështetja e bizneseve privatë.



Opinion *i* Ditës

Rilindja përballë pasqyrës së përgjimeve

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... në "Opinion" nga ish-deputeti Sali Jani është i paplotë dhe i pakuptueshëm për ata që nuk kanë dëgjuar fjalimin e Edi Ramës në kongres.

Fundjavën e shkuar, nga sheshi "Nënë Tereza", kryeministri ironizoi kadrinjtë e studiove që pyesnin njëri-tjetrin për çështjen "Babale". Me stilin tashmë të njohur, që e detyron të qesharëzohet afërat që i dëgjin më shumë, ai këmbënguli në versionin e vjetër, se historia e përgjimit të vëllait të ish-ministrit të Brendshëm, që një shpikje e inskenuar nga opozita dhe media.

Që kur kjo histori shpërtheu gati dhjetë muaj më parë, Rama gënjeu publikisht, se ai kishte provën e një laboratorit ndërkombëtar shkencor, që mbronte versionin e tij. Por, përfundimet e këtij "laboratori", të cilin nuk ia tha kurrë as emrin dhe as origjinën, u hodhën katërcipërisht poshtë si nga ekspertët italianë të kriminalistikës, po ashtu edhe nga homologët e tyre britanikë.

E megjithatë, gaztori që herë pas herë bën edhe rolin e kryeministrit, vazhdon të fliste për mediat e kazanit që fabrikojnë histori, për SHQUP-in që është kthyer në "Kinostudio", për derexhenë ku ka përfunduar babalo-partia.

Sot ne e dimë se nga rridhte siguria e fjalimeve prej klouni, që nuk e kursente sarkazmën për ata që vazhdonin të këmbëngulnin në skandalin e përgjimit që e implikonte vëllain e ish-ministrit në trafikun e drogës.

Në mënyrë miope dhe me vetëbesimin e tepruar se është në gjendje të manipulojë gjithçka, Rama kishte garancinë e bashibozukëve që e patën siguruar për manipulimin e një dëshmitari të



rremë.

Dhe këtu rikthehem i dy drejtuesit e policisë së Fierit, Berti Nushi dhe Andon Marko që u morën me përpunimin e këtij dëshmitari. Pyetjet që lindën pas dëgjimit të përgjimeve të shfaqura në "Opinion" ishin të shumta:

Si një drejtor dhe nëndrejtor policie mund të merret personalisht me një njeri që mbahet në mbikëqyrje nga prokuroria?

Pse duhet ta ndjekin nga pas, këmba-këmbës dhe ta bëjnë tapë me birra?

Pse duhet ta "bezdisin" edhe kur është duke zbratur ujin e hollë në WC?

Pse duhet t'i japin llogari për lëvizjen e "shefit të madh" jashtë

shtetit?

Pse duhet t'i dërgojnë në fund të fundit pako me para të pista?

Pse duhet që më tej të rrezikojnë edhe burgun, duke deklaruar në prokurori ndryshe nga ç'tregojnë përgjimet, se e kanë takuar vetëm një herë të vetme Alizotin?

Natyrisht, edhe profesionisti më i keq që e ka veshur vetëm prej pak ditësh uniformën nuk mund të vepronte në mënyrë kaq amatore. Por, fatkeqësia e Berti Nushi dhe Andon Markos nuk ishte se u sollën si policë të paaftë, por se vepruan si rilindas të devotshëm.

Ata paguan me para, dehën me alkool, shoqëruan me respekt dhe pranuan të tallen nga një

delinkuent, i cili i nevojitej rilindjes.

Sepse po t'i kthehem edhe njëherë pas historisë që plasi në 14 maj të vitit të kaluar, ajo ishte shumë e rëndë. Nga PD-ja u transmetua një videopërgjim, që pretendonte se vëllai i ministrit të Brendshëm, Agron Xhafaj merrej me trafik narkotikësh në Vlorë. Pas skandalit "Tahiri", vërtetimi i kësaj akuze ishte shkatërrimtar për qeverinë. Ndaj, ajo u detyrua të bënte dy lëvizje, së pari të dorëzonte menjëherë Agronin për krimet e mëparshme që kishte kryer në Itali dhe së dyti, të ndizte makinerinë e propagandës për të thënë se kjo ishte një shpifje.

Rama fillimisht gënjeu me his-

torinë e njohur se ai kishte provën shkencore që përgjimi ishte i sajuar. Por, pasi Roma refuzoi ta konfirmonte këtë version dhe pasi Londra dha një përgjigje krejt të ndryshme nga sa pretendonte kryeministri, alibia duhej të shpikjej në Tiranë.

Për këtë u gjet një kontingjent i policisë, si Alfred Alizoti, që u tregua i gatshtëm (ndoshta duke marrë para edhe në këmbim të disa muajve burg) të pohonte se që ai, aktori që e kishte interpretuar zërin e Agron Xhafajt.

Pikërisht, ky hall, ky merak për të shpëtuar shefat e tyre nga diskreditimi i shty dy drejtues të lartë policie të shndërrorshin në lolot e një keqbërësi lokal. Në emër të kësaj devotshmërie okulte, ata u sollën si shoqërues dhe pagatorë të Alizotit. Natyrisht, nga njëra anë, krimi i tyre është i paprecedent. Tentativa e një polici për të shpikur dëshmitarë dhe për të fabrikuar prova flet për korruptimin ekstrem të tij.

Por, nga ana tjetër, fati i tyre është sa tragjik po aq edhe komik. Sepse që të garantoni se nga kjo histori partia e tyre do dilte me nder, ata u shndërruan në vegla të një banditi ordiner.

Prandaj historia e tyre kriminale nuk mund të marrë kuptim, veçse nëse atë e lidh me fjalimin e fundit të Edi Ramës. Me atë kur tallej me kundërshtarët e tij, që vazhdonin të merreshin me historinë e "Babales".

Në fakt, përgjimet tregojnë të kundërtën. Tregojnë se ordinere dhe qesharake është administrata që ai ka ngritur, janë fabulat që Rilindja do t'u shesë si ushqim për të përtypur shqiptarëve.

Por, për të kuptuar këtë të vërtetë nuk duhet të shikosh fasadat e kongreseve, por të dëgjosh përgjimet e bisedave të njerëzve të saj me kriminelët.

BLUE TOOTH
THASHETHEME
MADE IN
ALBANIA

te rejat
nga jeta
ipave

çdo të shtuna falas me

Dje në Deutsche Welle

Sfida deti: Lufta e Greqisë për një nga burimet natyrore

Nga Florian Schultz

(vijon nga faqja 1)

... pak turistë. Në verë këtu vijnë mijëra vetë, që lenë pas plehtrat. Jo vetëm këtu, por në të gjitha plazhet e Greqisë qeset plastike, kupat e kafesë, dozat e birrës dhe bishtat e cigareve janë kthyer në problem serioz. "Tani është ende pastër", thotë një peshkatar që vjen këtu rregullisht. "Por po të vini në verë. Nuk ke ku të shkosh që të shpëtosh nga plehtrat."

Shumë njerëz në Greqi duan të luftojnë kundër ndotjes. Kudo persona privatë organizojnë aksione për pastrimin e plazhit, edhe këtu në Potamos. Rreth 50 vetë u mblodhën javën e kaluar për të çliruar plazhin nga plehtrat. "Shteti dhe komunat nuk kujdeset për problemin e plehrave. Ka shumë paka kazane plehrash dhe shpesh ato nuk zbrazen", thotë një nënë që vjen këtu me fëmijët.

PATRIOTIZËM ME FAKTOR TË QËNDRUESHËM

Gjithnjë e më shumë njerëz në Greqi duan të marrin pjesë aktive në mbrojtje të natyrës. Për këtë ata ndihmojnë një trend të ri që ka konjunkturë të madhe në mediat sociale. Me hashtagun si #beachcleanup ose #trashtag shumë njerëz bëjnë publike punën që ata bëjnë kundër ndotjes së ambientit. Mes tyre bëjnë pjesë edhe Marios dhe Kristina Bacharis. Ata janë organizatorët e të ashtuquajturës Beachcleanings në Epanomi. Marios ka lindur në Berlin nga prindër grekë. Që prej dy vjetësh ai, gruaja dhe fëmijët jetojnë në Selanik. Atij i pëlqen të jetojë në atdheun e prindërve të tij. Por pikërisht mungesa e vetëdijes për ambientin e shtëpisë: "Shumë vetë këtu ndihen rehat. Unë mendoj se njerëzit presin shumë prej shtetit, dhe nuk janë të gatshëm të bëjnë vetë diçka. Njeriu do që ambienti të jetë i bukur. Por kurrkush nuk mundohet për të. Ajo që duhet të ndodhë është punë e komunës."

Për Marion dhe gruan e tij ky mentalitet nuk ka asgjë të përbashkët me krenarinë e grekëve për atdheun. Ata e duan vendin dhe natyrën e veçantë. Qindra mijëra prej tyre dalin në rrugë të demonstrojnë kundër marrëveshjes për emrin e Maqedonisë veriore, por për të pastruar plazhin mezi mblidhen vetëm 100 vetë. Prandaj gëzimi është i madh kur gjithnjë e më shumë njerëz ndjekin thirrjen për të kaluar një ditë në heqjen e plehrave nga plazhet kombëtare.

MBROJTJE AMBIENTI DHE DEMOKRACI

Ioannis Giovos, punonjës i nisëm për mbrojtjen e detit iSea me qendër në Selanik i mbështet



aksione të tilla. "Këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me mbrojtjen e ambientit, por edhe me përgjegjësinë që qytetarët marrim mbi vetë. Në Greqi gjatë gjithë historisë ne kemi qenë kundër shtetit dhe kundër pushtetit shtetëror. Por kjo duhet të marrë fund, në mënyrë që gjërat të përmirësohen."

Ky mentalitet luan rol edhe në mënyrën se si trajtohet deti. Në kulturë deti ka një vlerësim të madh. Por, kur kemi të bëjmë me mbrojtjen e ambientit kemi të bëjmë me një akt balancues midis dashurisë dhe zakonit, thotë kolegu i tij, Nikos Doumpas: "Grekët e duan shumë detin, por kjo është për ta e vetëkuptueshme. Ata mendojnë se natyra e ofron të pastër detin ku ata mund të lahen". Megjithatë ata i lenë plehtrat në plazh. Larg syrit, larg zemrës? Për të luftuar këtë mentalitet, iSea organizon pro-

gramë për sensibilizimin e të rinjve që të bëhen mbrojtës aktiv të ambientit.

Sepse megjithëse kualiteti i ujërave në Greqi është i mirë në krahasim me vendet e tjera, plehtrat plastike dhe ujërat e zeza përbëjnë një problem të madh për ujërat greke. Ligjet europiane nuk kanë sjellë shumë ndryshime, thotë Giovos. Por, mentaliteti i hedhjes së plehrave nuk mund të kontrollohet me ligje. Aty kërkohet më shumë përgjegjësi personale. "Në Greqi sundon tek njerëzit mendimi se pak plehra nuk bëjnë dem. Ata ia lenë përgjegjësinë firmave të mëdha dhe politikës." Dhe ndryshimi i mentalitetit kërkohet kohë.

DETI SI HAPËSIRË EKONOMIKE

Edhe Stella Kyvelou dëshiron që deti të trajtohet me kujdes. Professore e ekonomisë në Univer-

sitetin Panteion të Athinës, ajo merret prej vitesh me studime për detin si Ressource. Ajo mbështet një nismë që quhet "zhvillimi blu", i inicuar më 2012 nga Komisioni Europian për t'i përdorur detet si mundësi zhvillimi dhe punësimi. Në Greqi ka 16 mijë kilometra bregdet. Faktikisht Greqia duhet të ishte një nga vendet kryesore për zhvillimin e strategjive të qëndrueshme për bashkimin e këtyre Ressourcive, thotë Kyvelou.

"Për ekonominë greke planifikimi i hapësirave maritimë po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, sepse ka të bëjë direkt me zhvillimin e aftësive konkurruese të një sektori të peshës. Njëpërjet shfrytëzimit të burimeve energetike, kabllove nënujorë dhe naftësjesllësve për furnizimin me energji, përfiton jo vetëm Greqia, por e gjithë BE." Këtu shtohen edhe ndërtimi i pikave turistike si vende prodhimi, zhvillimi i turizmit dhe nxjerrja e burimeve natyrore, si për shembull gaz, i cili mendohet të jetë me shumicë në bregdetin e Qipros. "Një gazsjellës nga bregdeti qipriot, që kalon në detin Jon dhe shkon deri në Europën kontinentale do të thotë t'i jepje fund varësisë nga gazi rus", - shpjegon Kyvelou.

Gjithnjë e më shumë njerëz në Greqi duan të marrin pjesë aktive në mbrojtje të natyrës. Për këtë ata ndihmojnë një trend të ri që ka konjunkturë të madhe në mediat sociale. Me hashtagun si #beachcleanup ose #trashtag shumë njerëz bëjnë publike

HOROSKOPI

DASHI

Është dita e duhur për t'u përpjekur maksimalisht për qëllimin tuaj. Do të keni rezultatin që dëshironi nëse tregoheni diplomatë gjatë zgjidhjes së një problemi emergjent. Nuk është koha e duhur për të rrezikuar duke ndërmarrë një projekt të ri.

DEMI

Disa Demi do të surprizohen nga një lajm që do të marrin këtë të enjte. Ka gjasa që ky lajm të vijë nga dikush që do të rikthehet sërisht në jetën tuaj. Në përgjithësi kjo ditë nuk do të sjellë probleme, por as ndonjë rezultat të rëndësishëm.

BINJAKET

Nuk ka ndonjë këshillë të veçantë sesi duhet të vepron. Kushtojni vëmendjen e duhur partneres/partnerit tuaj pasi do të ketë shumë nevojë për mbështetjen tuaj. Në mbremje ka gjasa të zhvilloni një bisedë të rëndësishme për të ardhmen me personin e zëmrrës.

GAFORJA

Gaforret duhet të përpigjen të gjejnë kompromis mes ambicies dhe realitetit objektiv. Ekziston mundësia që qëllimet tuaja të arrihen në një kohë të shkurtër. Shmangni ndërhyrjet e të huajve, pasi nuk do të kenë ndikimin duhur.

LUANI

Mos e shpenzoni energjinë për të tjerët. Ekziston rreziku që gjithçka që do të bëni në të mirë të të tjerëve nuk do të vlerësohet. Ekziston edhe mundësia që përpjekjet tuaja të keqinterpretohen. Mos ndani idetë me këdo, por vetëm me ata që i besoni.

VIRGJERESHA

Besojini intuitës suaj, pasi ka shumë mundësi që t'ju çojë drejt rrugës së duhur. Mos i besoni verbërisht gjithçkaje që dëgjoni rreth romancave spontane. Nëse në mbremje do të jeni në një takim të rëndësishëm, mos u përqipni të silleni si dikush tjetër.

PESHORJA

Peshoret rekomandohen të mos nxi-tojnë sot. Mos merrni përsipër detyra që nuk mund t'i realizoni. Mos mendoni vetëm por të ardhmen, por jetoni të tashmen. Detyra kryesore për këtë të enjte është të rregulloni marrëdhëniet tuaja personale.

AKREPI

Disa Akrepi do të ndihen të stresuar në punë sot. Do të bëjnë më shumë tërësi të kalorit me famijarët tuaj. Ata që janë të detyruar të punojnë më shumë seç e kishin parashikuar, këshillohen të përcendrohen vetëm tek vetja dhe të refuzojnë kërkesat për ndihmë, pasi do të jetë e pamundur për ju.

SHIGJETARI

Shigjetarët kanë mundësi ta kalonin këtë ditë nën shoqëri të partnerit/partneres. Ka gjasa të fitoni vëmendjen e një prej kolegëve. Shigjetarët e martuar mund të tundohen të nisnin një marrëdhënie sekrete, por mos harroni që ky do të ishte një gabim fatal.

BRICJAPI

Bricjapët do të jenë mjaft të ngarkuar në punë sot. Një projekt do të kërkojë vëmendje të veçantë nga ana juaj. Shpenzoni energjitë aty ku duhen dhe përqipni të mos shpërdandheni. Rekomandohet të kërkoni ndihmë nga personat tuaj të afërt.

UJORI

Përpiguni të mbani veten nën kontroll dhe tregohuni të përbujtur. Kjo këshillë vjen për të gjitha fushat e jetës. Shmangni presionin e tepër në marrëdhënien personale, por edhe ambicionin e tepër në punë.

PESHQIT

Ka gjasa që kjo ditë të mos sjellë shumë rezultate produktive. Arsyet për këtë mund të jenë përtesa, mungesa e fuqisë ose mungesa e interesit. Të gjitha këto do të jenë të papranueshme nëse keni një axhendë të ngarkuar përpara.

DETAJET E REJA



Edi Reja është i zgjedhuri i presidentit Armand Duka për stolin e Kombëtares kuqezi. Konfirmimi i radhës vjen nga gazetari i mirënjohur italian Alfredo Pedula, i cili nxjerr në pah dhe detaje të reja të bisedimeve mes palëve, ndërsa mban të gjallë dhe pistën e Luixhi Di Kanhos. Sipas Pedulas, Edi Reja ka kërkuar një periudhë reflektimi, ndërsa Federata Shqiptare e Futbollit pret nga tekniku itakian që

Reja kthen përgjigje të premtën, FSHF nuk pret më

të zgjidhë kontratën me Terzanën, klub me të cilin është i lidhur deri në vitin 2020. Ish-trajneri i Napolit, Lacios e Atalantës do ta thotë fjalën e fundit të premtën, me FSHF-në që shtyn për një përgjigje përpara fundjavës. Reja ka zgjedhur dhe zëvendësin e tij, Alesandro Kalorin, por gjithsesi çdo gjë do të varet nga fjala e fundit e teknikut të lidur në Gorica. Ndërkohë mbetet ende e gjallë dhe pista që të çon te Luixhi De Kanio, me ish-trajnerin e Udinezes dhe Xhenoa, që pëlqehet gjithashtu nga Duka.

EURO 2020

Ukraina rrezikon të humbasë dy ndeshje në tavolinë

Ukraina nisi në mënyrë të mirë eliminoret e Euro 2020. Në fillim barazoi pa gola në transfertën kundër Portugalisë, ndërsa në sfidën e dytë fitoi 2-1 në fushën e Luksemburgut dhe me katër pikë kryeson Grupin B. Por gjithçka mund të kthehet në një zhgënjim të madh, pasi skuadra e drejtuar nga Andrey Shevchenko rrezikon të humbasë në tavolinë të dyja ndeshjet e luajtura. E përditëshmjia portugeze "Record" zbulon se Federata e Futbollit të Luksemburgut ka reklamuar në FIFA prezencën në fushë të Junior Moraes në kundërshtim me rregulloren për natyralizimin e futbollistëve. Qeveria botërore e futbollit ka pranuar ankimmimin dhe ka nisur një hetim. Sulmuesi brazilian që luan me Shakhtar Donetsk u aktivizua për 19 minuta në sfidën kundër Portugalisë dhe për 90 minuta përballë Luksemburgut, duke shkeltur sipas këtij të fundit rregulloren e FIFA-s. Akuzat mbështeten në faktin se futbollisti nuk mund të luante me një kombëtare të ndryshme nga ajo e vendit të origjinës, pra Brazilit. Sipas FIFA-s, një lojtar mbi 18-vjeç, duhet të jetojë pa ndërprerje për 5 vjet në shtetin e tij të ri, përpara se të veshë fanelën e kombëtares së tij. Por Moraes ka jetuar në Ukrainë 4 vjet dhe 8 muaj, aq më tepër që në vitin 2017 u transferua për 6 muaj në Kinë për të luajtur me Tianjin Quanjian. I menjëhershëm ka qenë reagi i federatës ukrainase. "Sipas ligjit tonë, ai ka jetuar për 5 vjet në Ukrainë. Për të marrë shtetësinë në Ukrainë parashikohet që një person duhet të jetojë në vend vetëm 180 ditë brenda një viti", ka thënë sekretari i përgjithshëm Yuri Zapisotski.

Dy javë më parë federata mbështeti bojkotin e gjytarëve, dje u bë palë me dhunën ndaj tyre

Skandal i FSHF-së, fal lojtarin që dhunoi gjyqtarin Klajdi Kola

Disiplina dënon me dy javë pezullim Ardian Memën



Jeton Selimi

Federata Shqiptare e Futbollit tregon edhe njëherë anën më qesharake të saj, ndërsa pak ditë më parë mbështeti gjyqtarët në bojkotin e tyre, ndërsa dje ka falur një nga dhunuesit e gjyqtarëve, të cilin vetë Komisioni i Disiplinës e pati dënuar me 3 vjet pezullim nga fushat e blerta. Bëhet fjalë për Albano Isajin, lojtar i KF Shkumbinit që edicionin e shkuar goditi me grusht gjyqtarin Klajdi Kola menjëherë pas përfundimit të sfidës së play-out mes Shkumbinit dhe Veleçit, sfidë që ndëshkoi peqinasit me rënie në Kategorinë e Dytë.

Situata është skandaloze, pasi vetë FSHF u çorr dhe u ngjir për rikthimin e policisë në stadiume pas



episodëve të dhunës ndaj gjyqtarëve dhe udhëhoqi bojkotin e tyre, që solli krijimin e një tryeze të pëbashkët me qeverinë për akte ligjore kundër dhunuesëve dhe çështje të tjera të karakterit financiar në dobi të FSHF-së. Dhe ndërsa pret që institucioni i futbollit të jetë vetë shembull në të tilla raste të turpshme, ja tek ndodh ajo që mediat kanë kritikuar gjithnjë të Federata Shqiptare e Futbollit. Albano Isajit i është hequr pezullimi pas vetëm 7 muajsh, ndonës goditi një gjyqtar të shoqatës së udhëhequr nga Tahir Kastrioti. Qesharake dhe skandaloze bashkë!


Mema dënohet dy

ndeshje Sfidat ndaj Kastriotit vijon të ketë shumë kosto për ekipin e Tiranës. Pas humbës tre pikë pikërisht në ndeshjen më delikate të fazës së tretë, bardheblutë humbasin dhe shërbimet e trajnerit të tyre Ardian Mema. Protestat ndaj vendimeve të zyrtarit të ndeshjes i kanë kushtuar trajnerit Mema dy ndeshje pezullim, ky është vendimi i fundit i marrë nga Komisioni i Disiplinës. Pasi u largua nga bankina ende pa përfunduar ndeshja, Mema u përpoq të kërkonte llogari gjyqtarit Sokoli për atë penallti inekzistente që vendosi fatet e sfidës, një episod që bërë jo pak zhurmë.

80 MLN PËR LUKAS

Bajerni zyrtarizon blerjen më të shtrenjtë në histori

Uli Hënës e pati lajmëruar mediat e shkruanin prej kohësh, ndërsa dje është fakt! Revolucion i Bajernit të Mynihut ka nisur dhe me një bum të jashtëzakonshëm që bën tifozët të besojnë të ringritja e shpejtë e makinës perfekte bavareze. Sepse tanimë është zyrtare, Lukas Hernandez është bavarez. Kontratë 5 vjeçare për francezin që do fillojë nga 1 korriku 2019. Kostoja e transferimit është 80 milionë euro duke u bërë transferimi më i shtrenjtë në historinë e Bayernit dhe Bundesligës. Lajmin e ka bërë të ditur vetë klubi bavarez, ndërsa Hernandez është shprehur i lumtur për këtë transferim. "Sot është një nga ditët më të rëndishme në karrierën time futbollistike. Bajerni i Mynihut është një nga klubet më të mëdha në Europë. Jam i lumtur që do të luftoj bashkë me Bajernin për sa më shumë tituj".



Spaleti mund ta grumbullojë për Lacion

Ikardi dhe Perisic bëjnë paqe, spektakël në stërvitje

Shenjat e para të paqes mes Mauro Ikardit dhe Ivan Perisic janë vënë re qartë që në stërvitjen e kësaj të mërkure. Sinjalin e parë të sheshimit të mosmarrëveshjeve mes sulmuesit argjentinas dhe dy futbollistëve kroatë të Interit, Brozović dhe Perisic të rikthyer nga grumbullimi me kombëtaren kroate e dha mesfushori në rrjetet sociale me Marselon që i bëri like në Instagram lajmit të Sky Sport që bënte me dije rikthimin e Maurits në stërvitje me grupin. Gjithsesi në mungesë të Brozović, i cili këtë të mërkurë u stërviti i diferencuar, por nuk rrezikon të mungojë ndaj Lacios, Ikardi dhe Perisic në ndeshjen brenda grupit u vendosën në të njëjtën skuadër duke formuar sëbashku repartin e sulmit dhe mesa duket gjithçka shkoj ok siç, ku kombinimet mes tyre kanë sjellë disa gola. Me shumë gjasa Spaleti do ta grumbullojë ish-kapitenin për sfidën e së dielës në mbrëmje ndaj Lacios në 'San Siro', por Ikardi do ta nisë nga stoli pasi tashmë titullari në qendër të sulmit të Interit është Lautaro Martinez dhe Mauro duhet ta fitojë me meritë vendin në formacion.


E ZBULON L'EQUIPE

Zhoze Murinjo drejt Francës, e pret Lioni ose Monako

Zhoze Murinjo është zpa ekip që pas shkarkimit nga drejtimi i Manchester Junajtedit dhjetorin e shkuar. Portugezi, që së fundmi ka qenë i angazhuar si opinionist, është në pritje të ofertës së duhur dhe ekipit të duhur për të veshur sërish tutat në verë, sipas asaj që ka deklaruar vetë ish-trajneri i Realit dhe Interit. Por francezja "L'Equipe" zbulon dy emra skuadrash për të cilat fansat e futbollit kanë mbetur jo pak të befasuar. Zhoze Murinjo shumë shpejt mund të drejtojë një mes Lionit dhe Monakos. Kampionati francez, ndërsa portugezi duket i joshur nga ideja për të thyer një superfuqi si PSG. Gjithësi, mbetet për t'u parë nëse Mou do të pranohet.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Një pije freskuese.
- Graf ish teniste.
- Dada, ish-diktator i Ugandës.
- Është pasuri e investuar.
- Mund të jenë fetare.
- Një pjesë e relacionit.
- Fillojnë ambalazhimin.
- Një vegël.
- Qe harkëtar i famshëm i akejeve.
- Fillojnë hetimin.
- Një atentator vëtvërsas.
- Kështu janë takimet zyrtare.
- Është anije me dy sfafe.
- Fundi i Turandot.
- Inicialet e Reitman regjisor.
- Farell regjisor.
- Schneider që qe aktore.
- Mund të jetë e lirë për hartim.
- Emri i Pasternak.

- Ekberg e La dolce vita.
- Dikur quhej Mediolanum.
- Ruajinë pa ujë.
- Një mund të jetë kalendarik.
- Një është meskini, shpirtingush-ti.
- Një hidrokarbur.
- Mund të jetë franceskan.

VERTIKAL

- Jessica Parker aktore.
- Zola shkrimtar.
- Janë dritë të tilla me parsec.
- Mund të jenë gjaku.
- United Kingdom.
- Është njeri me principe.
- Një polimer për kirurgji estetike.
- Kufizojnë takimet.
- Diftong teatral.
- Fillojnë fluturimin.
- Makina Uno.
- Është shpend lagune.
- Është operator që bën zoom.
- Është i pashpirt.
- Parashtesë për një.
- Pak enigmatike
- Një pjesë e Toskërisë.
- Agustini ish-bomber.
- Kufizojnë një princip.
- Miku i Batman.
- Tapeti për judo.
- Janë stadet në videogame.
- Bëhet një kundër vendimit.
- Janë me blerim mbuluar në një film
- Është shtet aziatik.
- Papavrami violinist
- Fadil komik
- Përhëndetja e Jul Qezarit.
- Mbyllin fushatat.
- Me të bëjnë një ketër.
- Mbyllin një takimim.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Një pemë gjigante.
- Janë për të kërcyer.
- Është shkollë e Aristotelit
- Një thirrje me emra.
- Gjysmë rivale.
- Një pjesë e narkotikëve.
- Një tis... mjegulle
- E famshme ajo e Keopsit
- Mbyllin një sirtar
- Është ngjyrë e... fytyrës.
- Fillojnë lejen.
- Janë aktorë kryesorë.
- Janë kompozime të kënduara.
- Hudson aktore.
- Satelit i Uranit.
- Fillojnë tatëpjepën.
- Mbetur në fund.
- Sapo fillojnë.
- Kastile janë në fund.
- Kufij takimi.

VERTIKAL


- Mund të jetë sekrete në derë.
- Makina Agila.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Rrëzohen me strike
- Luciano tenor i paharruar.
- Mbyllin këndet.
- Është borxh.
- Mbyllin portat.
- Hagen rockstar.
- Një pjesë e akademisë.
- Bien me ballë.
- Një barkë lëkurëkuqsh.
- Atje ku shkon progresisti
- Pallati i Dalai Lamas në Lhasa
- Një pjesë e minoritetit.
- Është fluturues në ufo.
- Do të bëhen mace të tilla.
- Fletë pa kufij.
- I ka tek rendi.
- Kreshniku i volejbollit.
- Një det që është liqen në fakt.
- As unë, as ai.
- Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- Një parashtesë zmadhuese.
- Është lon papagalli
- Titulli i Sean Connery.
- Fillojnë panikun.
- Gjysma e rojave.
- Fitim pa kufij.
- Mbyllin një sherr.
- Fillojnë një metodë.
- Kufizojnë botimet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

6	5		1		3
		9			1
1			7		
	8		3		7 4
4				8	
	6				2
3		9			
7 2				3 6	
		5			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	1	4	8	2	5	6	3	9
3	2	8	4	6	9	7	5	1
6	9	5	7	1	3	4	8	2
4	6	2	9	3	8	1	7	5
5	3	1	2	7	4	8	9	6
8	7	9	6	5	1	2	4	3
9	8	6	5	4	2	3	1	7
1	5	7	3	8	6	9	2	4
2	4	3	1	9	7	5	6	8

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	1	11	16		7	5	15	8		3	8		K	U	L	T	M	A	P	L	A	B			
1	Z	8	13	8	6		6	8		4	3	8	12	O	R	E		K	A	S	T	I	L	E	R	
2	I	7		10	8	9	2		15	2	11	3	2	R	U	L		A	K	T	O	R	I	A	L	E
9	L		14	8	12	17	12	3	7	9	9	2		B		K	L	E	O	P	A	T	R	A		
	5	7	15	5	8	5	2	16	8	5		16		I	E	K	I	T	R	E	T	E		S		
4	8	6	5	2	15	8		7	15		10	7		L	A	M	E	K	E	R	M	A	T			
7	5	7		12	7	15		6	11	6	8	15		T	E	R	M	A	T		A	R	I	C	E	
5	6	4	7		5	2	18	2		11	19	7		O	T	O	S	C	I	R	M	A				
5	4	11	6	19				9	8		4	8	6	B	R	E	D	H	I	A	I	R	K			
9	11	15		1	7	5	8		19	8	1	8		I	L	E	I	N	E	P	H	I	L			
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7			A	N	A	L	I	T	I	K	E	A	M	I	
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5			S	E	T	E		S	K	I	C	A	T	O	

Argëtim filozofik

- Nuk më vjen keq për gënjeshtret që më the, por më vjen keq se unë kurë nuk kam për të të besuar përsëri.
- Një gënjeshtër bëhet më e besueshme kur fshihet në mes të dy të vërtetave.
- Pika më e lartë në një kishë nuk është kryqi por rufepërthesja. Një ironi e fizikës në metafizikë...
- E vërteta shkëlqen akoma edhe kur askush nuk e kërkon.
- Ekzistenca e kaq shumë feve tregon mungesën e një perëndie të vërtetë brenda tyre.
- Nuk kemi nevojë të fshihemi sepse keni frikë nga opinioni që të jjerit do të formojnë për ju.
- Duhet të jetosh jetën tënde.



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

M A K U T E R I T I M
A G A R R E N D M I K E
L I T A R E T E S O
E M I L E A P E L I M I
E L E D E P O Z I T A T
A T E K A P A N O N E T
I K A N A R I N E A M
E S S E N D A M E A N A
G I P A M I T E T E M E R
M I K A T E T E T I
K O R R I K U K O L L A
U N A Z A R E N D O R E

FJALËKRYQI (2)

M I R A N D A B I S H T I
I R A A R M A D H I D
T O A P A R A T E T A E
I N R I M O T E T U M A
I R D A M A R E T I L
T A K O T A N I O D
M K A B I N E T E R A R
P U R T E K E E T N I K E
P E R S E T E T N I M
L A O I G O T A L L A
I H H R T P E T E R I K
V O L E E L E N D E K

Thënie të mençura

- Para se të kërkonit atë që u tha në lidhje me ju, mësoni se kush e ka thënë atë. E dyta është më e rëndësishme dhe përcakton vlerën dhe rëndësinë e të parës.
- Ëndrrat janë si mrekullitë. Dalin të vërteta vetëm kur ju i besoni ato.
- Gjithçka që fillon me siguri, përfundon me dyshim.
- "Ai që di të dëgjojë, përfiton edhe nga ata që flasin keq."
- Krenaria merret me "kush ka të drejtë". Mençuria merret me "çfarë është e drejtë".

